



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.35	2004	7 Qershor
--------------	-------------	------------------

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 9223 datë 29.4.2004	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8530, datë 23.9.1999 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë"	2685
Ligj nr. 9224 datë 29.4.2004	Për shërbimin meteorologjik ushtarak	2686
Ligj nr. 9225 datë 29.4.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Spanjës për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe udhëtarëve"	2688
Ligj nr. 9226 datë 29.4.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin "Infrastruktura ujore bashkiake"	2695
Ligj nr. 9227 datë 29.4.2004	Për një ndryshim në ligjin nr.9118, datë 24.7.2003 "Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të papaguara"	2711
Ligj nr. 9228 datë 29.4.2004	Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare	2712
Ligj nr. 9229 datë 29.4.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile"	2719
Vendim i Kuvendit nr. 131 datë 19.4.2004	Për Komisionin Hetimor Parlamentar për hetimin në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare.....	2721

LIGJ
Nr.9223, datë 29.4.2004

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8530, DATË 23.9.1999 "PËR
SHËRBIMIN POSTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8530, datë 23.9.1999 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Pika 14 e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

"14. "Shërbime të rezervuara" nënkupton shërbimet e kryera ekskluzivisht nga operatori publik i postave, për të përmbushur detyrimin e shërbimit bazë për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve të korrespondencës së brendshme, me çmim dhe kufi peshe, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave."

2. Pas pikës 18 shtohen pikat 19 dhe 20 si më poshtë:

"19. "Licencë individuale" nënkupton të drejtën që i jepet çdo subjekti juridik, vendas ose i huaj, që plotëson kërkesat e legjislacionit shqiptar për shërbimet postare, për ofrimin e shërbimeve të tjera nga ato të rezervuara, që përfshihen në shërbimin bazë postar.

20. "Licencë e përgjithshme" nënkupton të drejtën që i jepet çdo subjekti fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që plotëson kërkesat e legjislacionit shqiptar për shërbimet postare, për ofrimin e shërbimeve të tjera nga ato të rezervuara, që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar."

Neni 2

Shkronja "b" e pikës 1 të nenit 11 ndryshohet si më poshtë:

"b) të ketë të drejtën e transportimit të objekteve të thjeshta të postës së letrave të brendshme, në peshën që do të përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Këtu përfshihen dhe objektet e postës së drejtpërdrejtë."

Neni 3

Titulli i kreut V bëhet "Licencat" dhe titulli i nenit 16 bëhet "Licenca individuale".

Neni 4

Neni 17 i ligjit ndryshohet si më poshtë:

"Neni 17

Licencat e përgjithshme

1. Shërbimet e tjera postare, që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar, ushtrohen pas dhënies së licencës së përgjithshme nga ministri.

2. Procedura për dhënien e licencës së përgjithshme përcaktohet nga ministri.

3. Një licencë e përgjithshme mund t'i jepet një personi fizik ose juridik, i cili:

a) plotëson kërkesat themelore të konfidencialitetit, të sigurisë dhe të mbrojtjes së të dhënave, si dhe respekton të drejtat ekskluzive që i jepen operatorit publik;

b) plotëson kërkesat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, për të ushtruar veprimtarinë postare.

4. Ofruesi i shërbimit është i detyruar të njoftojë DPPT-në për pezullimin dhe përfundimin e veprimtarisë së tij të paktën 30 ditë para marrjes së një veprimi të tillë.

5. Ofruesi i shërbimit duhet t'ia paraqesë tarifat për dijeni DPPT-së të paktën 15 ditë para vënies së tyre në zbatim, si dhe të japë çdo informacion, që i kërkohet nga ajo për kryerjen e funksioneve të saj.

6. Një ofrues i shërbimit, që ofron shërbimet në bazë të një licence individuale, sipas nenit 16 të këtij ligji, nuk ka nevojë për licencë të përgjithshme nga ministri, siç parashikohet në këtë nen.”.

Neni 5

Në të gjithë tekstin e ligjit, fjala "licencë" zëvendësohet me fjalët "licencë individuale" dhe fjala "leje" zëvendësohet me fjalët "licencë e përgjithshme".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4230, datë 26.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ

Nr.9224, datë 29.4.2004

PËR SHËRBIMIN METEOROLOGJIK USHTARAK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, si organ i specializuar për parashikimin e motit dhe përcaktimi i të drejtave e detyrave të tij.

Neni 2

Varësia

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak është pjesë përbërëse e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe varet nga Komanda e Forcave Ajrore.

Neni 3

Detyrat e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak kryen këto detyra:

a) studion njëkohësisht tërësinë e fenomeneve atmosferike në sipërfaqen e tokës dhe në lartësi në një orar të caktuar;

b) analizon elementet e ndryshme meteorologjike që përcaktojnë gjendjen aktuale të motit dhe në bazë të ndryshimit të elementeve meteorologjike, nëpërmjet modeleve matematikore, parashikon gjendjen e motit në të ardhmen;

c) siguron të dhëna meteorologjike në lartësi nëpërmjet lëshimit të radiosondave;

ç) analizon modelet matematikore të hartave për parashikimin e motit dhe bën parashikimin e tij 24-orësh dhe 5-ditor për të gjithë territorin e Republikës;

d) bën vërtetime meteorologjike, mbledh të dhëna nga stacionet dhe transmeton të dhëna për organizata ndërkombëtare të specializuara në fushën e parashikimit të motit ose për të tretët të interesuar brenda dhe jashtë vendit;

dh) jep asistencë meteorologjike për sigurinë e popullsisë, të fluturimeve ajrore ose të lundrimit detar, si dhe në raste emergjencash civile;

e) shkëmben të dhëna për meteorologjinë me institucionet simotra të shteteve të tjera.

Neni 4

Njoftimi i të dhënave

1. Të dhënat për parashikimin e motit u jepen pa pagesë institucioneve shtetërore në nivel qendror ose vendor, si dhe Forcave të Armatosura.

2. Të dhënat për parashikimin e motit u jepen subjekteve private kundrejt pagesës së përcaktuar me urdhër të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Financave.

3. Ndalohet njoftimi i të dhënave meteorologjike nga subjekte të tjera të paaautorizuara.

Neni 5

Organizimi

1. Shërbimi Meteorologjik Ushtarak e ka qendrën dhe selinë tij në Tiranë dhe ka degë vendore në njësitë territoriale të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

2. Stacionet e degëve vendore për parashikimin e motit bëjnë vërtetimin meteorologjik të rajonit të tyre gjatë 24 orëve dhe detyrohen t'i transmetojnë ato në qendrën e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak.

3. Niveli i pagave dhe limiti organik i punonjësve të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.

4. Organizimi i Shërbimit dhe Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Shërbimit bëhen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes dhe me propozimin e Komandës së Forcave Ajrore.

Neni 6

Vendmatjet meteorologjike

1. Vendmatjet meteorologjike duhet të jenë në afërsi të qendrave të banuara dhe larg sipërfaqeve kodrinore.

2. Ndalohet ndërtimi i ndërtesave të larta në afërsi të këtyre vendmatjeve.

Neni 7

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, në ushtrimin e detyrave të tij ligjore, bashkëpunon mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara me institucionet e specializuara hidrometeorologjike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 5 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë:
 - a) udhëzimin për përgatitjen e hartave dhe buletineve meteorologjike, dërgimin e mesazheve, si dhe përmbajtjen, mënyrën dhe përparësitë në njoftimin e të dhënave meteorologjike;
 - b) urdhrin për përcaktimin e degëve vendore të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak;
 - c) urdhrin për organizimin dhe Rregulloren e Brendshme të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, sipas nenit 5 pika 4 të këtij ligji.
3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave të nxjerrin urdhrin e përbashkët, sipas nenit 4 të këtij ligji.

Neni 9
Shfuqizime

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4231, datë 26.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.9225, datë 29.4.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË SPANJËS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE DHE UDHËTARËVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Spanjës për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe udhëtarëve”, nënshkruar në Tiranë më 10 prill 2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4232, datë 26.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË
TË SPANJËS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE DHE
UDHËTARËVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Spanjës, të quajtura më poshtë Palë Kontraktuese,

me dëshirën për të favorizuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e transportit rrugor ndërmjet vendeve të tyre dhe në transit nga territoret e tyre, të frymëzuara nga parimi i liberalizimit që lidhet me transportin rrugor; mbi bazën e parimit të reciprocitetit dhe të interesit të përbashkët, ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për:

1. Transportin rrugor të mallrave dhe udhëtarëve ndërmjet dy Palëve Kontraktuese, në transit nëpërmjet territoreve të tyre dhe ndërmjet territorit të njëres nga Palët Kontraktuese dhe një vendi të tretë.

2. Udhëtimin e mjeteve bosh në lidhje me transportin e përmendur më lart.

Neni 2

Kjo Marrëveshje nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga angazhime të tjera ndërkombëtare të Palëve Kontraktuese, si dhe nuk ndikon ligjin e Bashkimit Europian apo marrëveshjet ndërmjet Bashkimit Europian dhe shteteve joanëtare.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. Me termin “transportues” nënkuptojmë një person fizik ose juridik të regjistruar në njërin nga Palët Kontraktuese, i cili ka të drejtën të kryejë transport rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në vendin e tij.

2. Me termin “mjet” nënkuptojmë:

- për transportin e mallrave: një mjet motorik ose një kombinim i mjeteve nga i cili të paktën mjeti motorik është i regjistruar në njërin nga Palët Kontraktuese dhe i cili përdoret dhe është i licencuar vetëm për transportin e mallrave;

- për transportin e udhëtarëve: çdo automjet i regjistruar në territorin e njëres nga Palët Kontraktuese, i cili si rrjedhojë e ndërtimit dhe pajisjeve të tij, është i përshtatshëm për të transportuar më shumë se nëntë persona të ulur, duke përfshirë edhe shoferin.

3. Me termin “transit” nënkuptojmë transportin e udhëtarëve dhe të mallrave nga një transportues i regjistruar në një Palë Kontraktuese nëpërmjet territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

I. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

A. Qëllimi dhe përkufizime

Neni 4

Me qëllim transportin e udhëtarëve, kjo Marrëveshje do të zbatohet:

- Për të gjitha shërbimet e transportit të udhëtarëve, për të tretë ose me qira ose për llogari të vet të kryera me automjete (autobus dhe mikrobuses) ndërmjet dy Palëve Kontraktuese, në transit nëpërmjet territoreve të tyre dhe nëpërmjet territorit të njëres nga Palët Kontraktuese dhe një vendi të tretë.

- Për udhëtimet bosh të mjeteve në lidhje me këto shërbime.
- Me termin “transport udhëtarësh për llogari të vet” nënkuptojmë transportet e kryera nga një subjekt për punonjësit e tij ose nga një shoqatë jofitimprurëse për anëtarët e saj në lidhje me objektivat e saj sociale duke siguruar që:

- a) aktiviteti i transportit të jetë një aktivitet plotësues i këtij subjekti ose shoqate;
- b) mjetet e përdorura janë pronë e këtij subjekti ose shoqate ose janë siguruar mbi terma të mëvonshëm nga ata ose janë subjekt i një kontrate qiraje afatgjatë dhe janë drejtur nga një anëtar i stafit të subjektit ose shoqatës.

Neni 5

Për qëllimin e transportit të udhëtarëve:

1. Me “Shërbime të rregullta” nënkuptojmë shërbimet që sigurojnë transportin e udhëtarëve sipas një frekuence të caktuar dhe itinerari udhëtimi të përcaktuar më parë, ku zbriten dhe merren udhëtarë nëpër pika vendqëndrimi të parashikuara. Shërbimet e rregullta mund të jenë subjekt i detyrimit të respektimit të tarifave dhe orarëve të caktuar më parë.

2. Me “Shërbime vajtje-ardhje” nënkuptojmë shërbime të cilat me anën e udhëtimeve të përsëritura vajtje dhe ardhje kryejnë transportin e grupeve të udhëtarëve të formuara paraprakisht, nga një vend i vetëm nisjeje në një destinacion të vetëm, të vendosura respektivisht në të dy Palët Kontraktuese. Çdo grup i përbërë nga udhëtarët që bëjnë udhëtimin e vajtjes do të kthehet në vendin e nisjes në një udhëtim të mëvonshëm.

a) gjatë shërbimeve vajtje-ardhje asnjë udhëtar nuk mund të merret ose të zbritet gjatë udhëtimit.

b) udhëtimi i parë në ardhje dhe i fundit në vajtje në një seri udhëtimesh vajtje-ardhje do të bëhet bosh.

c) shërbimet e rregullta dhe shërbimet vajtje-ardhje dhe kushtet në lidhje me kryerjen e tyre duhet të vendosen mbi bazën e një marrëveshjeje të përbashkët të autoriteteve kompetente ose direkt, ose mbi bazën e konkluzioneve të marra nga Komiteti i Përbashkët, i cili është vendosur në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje.

3. “Shërbimet e rastit” janë:

a) udhëtime me dyer të mbyllura që nënkupton shërbimet ku i njëjti automjet përdoret për të transportuar të njëjtin grup udhëtarësh gjatë udhëtimit dhe për t'i kthyer ata në vendin e nisjes, i cili është vendi i regjistrimit të automjetit;

b) shërbimet që bëjnë udhëtimin në vajtje me udhëtarë dhe udhëtimin në kthim bosh;

c) shërbimet që bëjnë udhëtimin në vajtje bosh dhe kthimin me udhëtarë, të marrë në të njëjtën pikë të vendit ku automjeti nuk është i regjistruar, me kusht që udhëtarët:

1. të përbëjnë një grup të formuar më parë nën një kontratë transporti e përfunduar përpara mbërritjes së tyre në territorin e Palës Kontraktuese ku ata janë marrë, ose

2. janë dërguar paraprakisht nga i njëjti transportues sipas kushteve të paragrafit 3 rasti b dhe duke siguruar që ata janë marrë përsëri dhe janë kthyer në territorin e vendit ku është regjistruar operatori i transportit;

3. janë ftuar për të udhëtuar në territorin e vendit ku është regjistruar operatori i transportit, kostoja e transportit mbulohet nga personi që ka lëshuar ftesën;

d) çdo shërbim tjetër që nuk përmendet në nënparagrafët e mësipërm.

B. Pranimi në treg

Neni 6

1. Shërbimet e rastit që përmenden në nenin 5 paragrafi 3 (a) deri tek (c), do të përjashtohen nga nevoja për leje transporti në territorin e Palës Kontraktuese, ku mjeti nuk është i regjistruar.

2. Shërbimet e rastit duhet të kryhen të shoqëruara nga një dokument kontrolli.

3. Dokumenti i kontrollit përbëhet nga një fletudhëtimi.

4. Fleta e udhëtimit duhet të përmbajë të paktën informacionet e mëposhtme:

a) llojin e shërbimit;

b) itinerarin kryesor;

c) transportuesin (it) e përfshirë;

e) listën e plotë të udhëtarëve.

Në rastin e paragrafit 3c (1) të nenit 5, do të kërkohej një kopje e kontratës së transportit.

Në rastin e paragrafit 3c (2) të nenit 5 do të kërkohej dokumenti që shoqëron automjetin gjatë udhëtimit në vajtje plot dhe udhëtimit në kthim bosh.

Në rastin e paragrafit 3/c (3) të nenit 5, do të kërkohej ftesa ose një kopje e saj.

5. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, ku është regjistruar mjeti ose organet e caktuara prej këtyre autoriteteve duhet të lëshojnë blloqet e fletudhëtimeve.

6. Shërbimet e rastit referuar në nenin 5 paragrafi 3/d, mund të kryhen vetëm mbi bazën e licencave të vlefshme. Numri dhe tipi i licencave duhet të vendoset nga Komiteti i Përbashkët, referuar në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje.

7. Në transportin transit, asnjë udhëtar nuk mund të merret ose të lihet gjatë udhëtimit, përveç rastit kur Palët Kontraktuese vendosin ndryshe nëpërmjet Komitetit të Përbashkët të nenit 14.

8. Nuk duhet leje për zëvendësimin e ndonjë autobusi me defekt, si dhe për udhëtimet e automjeteve bosh, të cilët do të kryejnë transportin sipas nenit 4 të mësipërm.

9. Transporti i udhëtarëve për llogari të vet është subjekt i lejeve të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Neni 7

1. Shërbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje janë subjekt i autorizimeve.

2. Autorizimet do të lëshohen në emër të subjektit të transportit. Ato nuk mund t'i transferohen nga subjekti i transportit palëve të treta. Megjithatë, transportuesi i cili ka marrë autorizimin, mund të kryejë shërbimin (shërbimet) nëpërmjet një nënkontraktori.

3. Periudha e vlefshmërisë së një autorizimi nuk duhet të kalojë 5 (pesë) vjet për shërbimet e rregullta dhe një vit për shërbimet vajtje-ardhje.

4. Autorizimet duhet të specifikojnë treguesit e mëposhtëm:

a) llojin e shërbimeve;

b) itinerarin e shërbimit, duke dhënë në mënyrë të veçantë vendin e nisjes dhe vendin e mbërritjes, si dhe pikat e kalimit kufitar;

c) periudhën e vlefshmërisë së autorizimit;

d) për shërbimet e rregullta, ndalesat dhe orarët.

5. Kërkesat për autorizime do të paraqiten në autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese ku është regjistruar mjeti, i cili mund ta pranojë atë ose jo. Në rast se nuk ka vërejtje për kërkesën, autoriteti i lartpërmendur do t'ia komunikojë këtë autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese. Nëse ky i fundit bie dakord, atëherë secili kompetent lëshon autorizimin për atë pjesë të itinerarit që i përket territorit të tij.

6. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e kërkuara nga rregullat kombëtare, si dhe një përshkrim të linjës që përmban ndalesat dhe kilometrat e autobusit të shënuara qartë. Autoritetet përgjegjëse kanë të drejtë të kërkojnë nga transportuesit çdo të dhënë përkatëse që ata e konsiderojnë të nevojshme.

7. Gjatë udhëtimit një kopje e autorizimit, e noteruar nga autoriteti zyrtar që e ka lëshuar ose origjinali i tij duhet të jenë në mjet.

8. Autorizimet duhet të jenë konform modeleve të rëna dakord nga Komiteti i Përbashkët, të përmendura në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje.

9. Shërbimet e rregullta në transportin transit kryhen me autorizime, të dhëna prej vendit, territori i së cilës do të kalonte transit, pas një kërkesë me shkrim me gjithë anekset e nevojshme që i bëhen asaj nga vendi që ka dhënë autorizimin për shërbim të rregullt. Vlefshmëria e tyre do të jetë nga 1-5 vjet dhe do të lëshohen pa pagesë.

10. Shërbimet e rregullta ndërmjet dy vendeve ose në transit nëpërmjet territoreve të tyre duhet të aprovohen bashkërisht nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mbi bazën e parimit të reciprocitetit.

Neni 8

Në rastin e shërbimeve të rastit, udhëtimi transit përmes territorit të një Pale Kontraktuese që kryhet nga mjeti i regjistruar në Palën tjetër, përjashtohet nga çdo lloj autorizimi.

Neni 9

Një shërbim i rregullt quhet i miratuar dhe mund të fillojë operimin menjëherë sapo autoritetet përgjegjëse të të dyja Palëve Kontraktuese shkëmbejnë licencat e veçanta me të gjitha anekset e nevojshme.

II. TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 10

1. Transportuesit e regjistruar në territorin e njëres prej Palëve Kontraktuese lejohen të kryejnë transport ndërkombëtar rrugor mallrash, për të tretë ose me qira ndërmjet dy Palëve Kontraktuese (transport bilateral), si dhe transport përmes territoreve të tyre për në vende të treta (transporti transit), duke përdorur një leje të lëshuar nga autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Përsa i përket transportit rrugor të mallrave që realizohet nga transportues të një Pale Kontraktuese, nisur nga ose në drejtim të territorit të Palës tjetër Kontraktuese dhe nisur nga ose në drejtim të një vendi të tretë (transportet trekëndore) duhet të lëshohet një leje speciale nga Pala Kontraktuese nga e cila ose drejt së cilës kryhet transporti.

3. Këto leje speciale mund të përdoren vetëm nga transportuesit në emër të të cilit janë lëshuar dhe nuk janë të transferueshme.

Neni 11

Lloji dhe numri i lejeve, të përmendura në nenin 10, do të përcaktohet nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese direkt ose në bazë të konkluzioneve të adoptuara nga Komiteti i Përbashkët sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Në bazë të nenit 10 paragrafit 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë çdo vit lejet e kërkuara nëpërmjet kanaleve diplomatike ose nëpërmjet procedurës së vendosur nga Komiteti i Përbashkët i përmendur në nenin 14.

Neni 13

Ndryshe nga dispozitat e nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje, lejet nuk janë të detyrueshme në rastet e mëposhtme:

1. Transporti i mallrave me mjete motorike, pesha totale e ngarkesës së lejueshme (TPLW) e të cilave, duke përfshirë edhe trailerat, nuk i kalon 6 tonët, ose kur ngarkesa e lejueshme, duke përfshirë edhe trailerat, nuk i kalon 3.5 tonët.

2. Transporti i mallrave mbi një bazë të rastësishme, për në ose nga aeroporti, në rastet kur shërbimet janë devijuar.

3. Transporti i mjeteve të cilat janë dëmtuar ose janë prishur dhe lëvizja e mjeteve për riparimin e dëmeve.

4. Udhëtimet pa ngarkesë të një mjeti mallrash i dërguar për të zëvendësuar një mjet, i cili ka pasur dëmtime në një vend tjetër, si dhe kthimi pas riparimit të mjetit të dëmtuar.

5. Transporti i gjësë së gjallë në mjete të ndërtuara për këtë qëllim ose të konvertuara përgjithmonë për transportin e gjësë së gjallë.

6. Transporti i pjesëve të këmbimit dhe i rezervave për anijet transoqeanike dhe për avionët.
 7. Transporti i pajisjeve dhe mjeteve mjekësore të nevojshme për emergjenca, në veçanti, në rastet e katastrofave natyrore dhe nevojave humanitare.
 8. Transporti për qëllime jotregtare të punimeve dhe objekteve të artit për panaire dhe ekspozita.
 9. Transporti për qëllime jotregtare i mjeteve, aksesorëve dhe kafshëve për në ose nga shfaqje teatrale, muzikore, filma sporti ose cirku, panaire ose festivale dhe ato për qëllim regjistrimi radiofonik, ose për filma ose për prodhime televizive.
 10. Transporti i mallrave për qëllim të vet.
 11. Transporti funeral.
 12. Transporti i postës i kryer si një shërbim publik.
- Përsa i përket transporteve të përmendura në këtë nen, shoferi duhet të ketë të gjitha letrat dhe dokumentet që tregojnë qartësisht që po kryhet një nga transportet e përmendura më lart.

III. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 14

Me qëllim që të rregullohen të gjitha çështjet lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të krijohet një Komitet i Përbashkët.

Ky Komitet do të përbëhet nga përfaqësues të qeverive të të dyja Palëve Kontraktuese, të cilët mund të ftojnë në mbledhje përfaqësues të industrisë së transportit rrugor.

Komiteti i Përbashkët do të mbledhet një herë në vit ose me kërkesë të njërës prej Palëve Kontraktuese, në mënyrë alternative në territorin e njerës prej Palëve Kontraktuese.

Axhenda e takimit duhet të paraqitet nga Pala Kontraktuese pritëse ose kërkuuese, në varësi të rastit. Çdo takim do të mbyllet me hartimin dhe miratimin e një protokolli, që do të nënshkruhet prej kryetarëve të delegacioneve të të dyja Palëve Kontraktuese.

Komiteti i Përbashkët do të vendosë për qëllimin dhe, gjithashtu mbi mënyrën e shkëmbimit të të dhënave dhe të të gjitha informacioneve të tjera përkatëse.

Neni 15

Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën rreth emrave dhe adresave të autoriteteve kompetente respektive për të zbatuar Marrëveshjen aktuale. Ata do të komunikojnë çdo ndryshim mbi çështjet e mësipërme.

Neni 16

1. Mjetet të cilat janë regjistruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese dhe që përkohësisht janë importuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për të kryer shërbime transporti në përputhje me këtë Marrëveshje do të përjashtohen, në përputhje me parimin e reciprocitetit, nga taksat mbi automjetet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të kësaj Marrëveshjeje nuk aplikohen për taksat të lidhura me përdorimin e autostradave, urave dhe infrastrukturave të tjera, të cilat do të vendosen mbi bazën e principit të jodiskriminimit.

3. Në transportet e kryera sipas kësaj Marrëveshjeje, importimi i përkohshëm i mjeteve të një Pale Kontraktuese në Palën tjetër Kontraktuese përjashtohet nga detyrimet doganore, taksat dhe detyrime të tjera.

4. Karburanti për mjetet, i transportuar në depozita normale, karburanti i vendosur nga prodhuesi për këtë qëllim, si dhe vajrat lubrifikante të transportuara në mjete vetëm për qëllim të operimit të tyre, do të përjashtohen nga detyrimet, taksat dhe detyrimet e tjera të vendosura nga Pala Kontraktuese.

5. Pjesët e ndërrimit dhe veglat përkohësisht të importuara për riparimin e një mjeti të dëmtuar

gjatë kryerjes së një transporti ndërkombëtar rrugor do të përjashtohen nga detyrimet doganore, taksat dhe detyrimet e tjera në kohën e importimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese sipas kushteve të shprehura në dispozitat e saj përsa i përket importimit të këtyre mallrave. Pjesët e ndërrimit të cilat janë ndërruar duhet të rieksporthen ose të shkatërrohen nën kontrollin e autoriteteve kompetente doganore të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 17

Transportuesit e një Pale Kontraktuese dhe personeli i mjeteve të tyre, kur hyjnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet të zbatojnë ligjet dhe rregullat në fuqi të atij vendi.

Neni 18

Siguracioni

Mjetet e Palëve Kontraktuese që kryejnë transport ndërkombëtar duhet të jenë pajisur me siguracion si për vendet e destinacionit, ashtu edhe për vendet transit.

Neni 19

Kabotazhi

Kryerja e shërbimeve të kabotazhit si për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave është i ndaluar.

Neni 20

Kontrolli doganor dhe shëndetësor

Dispozitat e konventave ndërkombëtare të miratuara prej Palëve Kontraktuese zbatohen për kontrollin doganor e shëndetësor në pikat transite të kufirit.

Kontrolli i përmendur kryhet, nëse është e mundur me përparësi, në rastet e transportit të pacientëve, kafshëve dhe mallrave që prishen shpejt.

Neni 21

Kontrolli teknik i mjetit

Çdo mjet i Palëve Kontraktuese që kryejnë transport dypalësh ose transport transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese duhet të jetë i pajisur nga autoritetet shtetërore me një certifikatë teknike të vlefshme.

Çdo mjet i Palës Kontraktuese që kryen transport bilateral ose transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe transporton mallra të rrezikshme duhet të ketë të gjitha dokumentet e parashikuara nga konventa ADR.

Neni 22

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e shkëmbimit të letrave që vërtetojnë plotësimin e kërkesave ligjore respektive të Palëve Kontraktuese. Ajo do të qëndrojë në fuqi për një vit. Pas kësaj ajo do të shtyhet automatikisht për periudha të tjera njëvjeçare, në qoftë se njëra nga Palët Kontraktuese nuk njofton tjetrën, gjashtë muaj përpara mbarimit të datës, për vendimin e saj për ta përfunduar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 10.4.2003 në tri kopje origjinale në gjuhët shqip, spanjisht dhe anglisht, të cilat janë të barasvlefshme.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshje në interpretim, teksti anglisht do të mbizotërojë.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar plotësisht kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

LIGJ
Nr.9226, datë 29.4.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE PËR PROJEKTIN “INFRASTRUKTURA UJORE BASHKIAKE””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Infrastruktura ujore bashkiake””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4233, datë 26.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONTRATË FINANCIMI
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE

Kjo kontratë lidhet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, që vepron për qëllimet e kësaj kontrate nëpërmjet Shkëlqesisë së tij Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës, z.Artur Kuko, në vijim e quajtur “Huamarrësi”, nga njëra anë, dhe Bankës Europiane të Investimeve, me seli në Luksemburg, e përfaqësuar nga DRR.Dunnett, ndihmësdrejtor dhe P.Walsh, drejtor, në vijim e quajtur “Banka”, nga ana tjetër, ku:

1. Katër kompani ujësjellës-kanalizime në pronësi të shtetit shqiptar, që operojnë respektivisht në bashkitë e Lezhës dhe të Shëngjinit, të Durrësit, të Sarandës dhe të Korçës, synojnë të realizojnë skemat, të cilat kanë qëllim rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimeve në zonat e tyre operative, të cilat së bashku formojnë “Projektin” më në veçanti, i përshkruar në përshkrimin teknik (në vijim i quajtur “Përshkrim teknik”) i dhënë në grafikun A.

2. Kostoja totale e projektit është vlerësuar nga Banka rreth 73 200 000 euro (shtatëdhjetë e tre milionë e dyqind mijë euro) për t’u financuar në përputhje me planin e mëposhtëm të financimit (në milionë euro):

	Lezhë/Shëngjin Durrës & Sarandë	Korçë	Projekti në total
i) Fonde personale të përfituesve përfundimtarë dhe/ose fonde të buxhetit të Huamarrësit	2.2	4.4	6.6

ii)	Grant i lehtësirave mjedisore globale ("GEF")	4.4	-	4.4
iii)	Grant i Lux-Development S.A. ose burime të tjera	1.0	1.0	2.0
iv)	Hua nga Banka Gjermane për Rindërtim-KfW	-	21.2	21.2
v)	Disa hua nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqata e Zhvillimit Ndërkombëtar ("WB/IDA")	<u>12.0</u> 19.6	- 26.6	<u>12.0</u> 46.2
3.	Në mënyrë që të kompletohet financimi i kërkuar, Huamarrësi ka kërkuar një kredi nga Banka në një shumë prej	<u>12.5</u> 32.1	<u>14.5</u> 41.1	<u>27.0</u> 73.2

4. Fondet për t'u siguruar nga Banka nën këtë kontratë financimi ("Kontrata") duhet të jenë të disponueshme për të katra kompanitë e ujësjellës-kanalizimeve të përmendura në kapitullin e parë për financimin e pjesshëm për katër skemat e përmendura në pikën 2 të përshkrimit teknik (secila është një "Skemë") nën marrëveshjet e huave, të cilat do të lidhen midis Huamarrësit si dhënës dhe secilës prej këtyre kompanive në pozicionin e huamarrësit, forma dhe termat individualë të të cilave janë të kënaqshme për Bankën (secila prej tyre do të jetë një "Marrëveshje huaje").

5. Statuti i Bankës përcakton që Banka duhet të sigurojë se fondet e saj janë përdorur në mënyrë sa më racionale që të jetë e mundur me interesat e Komunitetit Europian dhe në përputhje, termat dhe kushtet e operimeve të huasë së Bankës duhet të jenë konsistente me politikat relevante të Komunitetit Europian.

6. Banka, duke qenë e kënaqur që operimi prezent është brenda qëllimit të funksioneve të tij dhe duke pasur në konsideratë çështjet e cituara më lart, ka vendosur të veprojë kundrejt kërkesës së Huamarrësit duke krijuar një kredi në një shumë prej 27 000 000 euro (njëzet e shtatë milionë euro).

7. Referencat për kapitujt, nenet, grafikët dhe anekset janë referenca respektivisht të kapitujve, neneve, grafikëve dhe anekseve të kësaj kontrate.

8. Përveç rasteve kur konteksti kërkon ndryshe, në këtë kontratë (duke përfshirë grafikët dhe kapitujt), çdo term i dhënë më poshtë ka kuptimin e përcaktuar për të në nenin, kapitujt apo grafikun krahas:

TERMI	NENI OSE KAPITULLI
Ndryshimi i kontrollit të ngjarjes	4.03 C
Kontrata	Kapitulli i 4-t
Kredia	1.01
Njoftimi për disbursim	1.02 C
Kërkesa për disbursim	1.02 A
Euribor	Grafiku B
Përqindja e zhvendosjes e BEI-t	4.02B
Përfituesi përfundimtar	1.04B
GEF	Kapitulli i 2-të
Hua	2.01
Koha e punës në Luksemburg	1.02C
Marrëveshja e huasë	Kapitulli i 4-t
PIU	6.08
Data e pagimit	5.03
Shuma e parapagimit	4.02A
Data e parapagimit	4.02A
Njoftimi i parapagimit	4.02A
Projekti	Kapitulli i I-rë
Shpenzimet kualifikuese	1.04B
Data e përcaktuar e disbursimit	1.02C(b)
Skema	Kapitulli i 4-t
Kontrata e livrimit	1.04B

Marrëveshja e asistencës teknike	6.09B
Objektivi i ditës së punës	5.03
Përshkrimi teknik	Kapitulli i I-rë
Transhi	1.02A
WB/IDA	Kapitulli i II-të

Për këtë arsye, tani është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Disbursimi

1.01 Kredia

Me anë të kësaj kontrate Banka krijon në favor të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon një kredi (në vijim e quajtur “Kredi”) prej 27 000 000 euro (njëzet e shtatë milionë euro) për qëllimin e vetëm të bashkëfinancimit të projektit.

1.02 Procedura e disbursimit

A. Subjekt i kushteve relevante të nenit 1.04, Huamarrësi mund të dorëzojë pranë Bankës një ose më shumë kërkesa me shkrim, të nënshkruara saktësisht (secila prej tyre në vijim e quajtur “Kërkesa e disbursimit”) për disbursimin e çdo pjese të kredisë (çdo pjesë e së cilës ose për disbursim, ose siç e përcakton konteksti për t’u disbursuar, në vijim e quajtur (“Transh”), që përcakton se kredia duhet të disbursohet në jo më shumë se 10 transhe, të cilat-duhet të ruajnë nëse balanca e kreditit nuk e lejon një gjë e tillë-të jenë në një shumë minimale prej 1.0 milionë euro.

B. Çdo kërkesë disbursimi duhet të specifikojë:

a) shumën për t’u disbursuar dhe alokimin e saj të propozuar nga Banka te një ose më shumë përfitues përfundimtarë për financimin e skemave relevante;

b) data e preferuar nga Huamarrësi për disbursim, duke qenë në dijeni që Banka mund të disbursojë shumën deri në katër muaj kalendarikë nga data e kërkesës së disbursimit;

c) përqindja e përcaktuar e interesit e aplikueshme për shumën që do të disbursohet, nëse Banka e ka bërë të ditur paraprakisht këtë përqindje interesi pranë Huamarrësit; pa përkushtim, të jetë e aplikueshme për transhin gjatë periudhës së kohëzgjatjes së tij;

d) datat e preferuara për pagesën nga Huamarrësi, të zgjedhura në përputhje me nenin 5.03;

e) termat e shlyerjes të preferuara nga Huamarrësi, të zgjedhura në përputhje me nenin 4.01.

Kërkesat për disbursim nuk mund të bëhen më vonë se 30 shtator 2009. Subjekti i dispozitave të nenit 1.02C, çdo kërkesë disbursimi është e pakthyeshme.

C. Midis 10 dhe 15 ditëve përpara datës së disbursimit të çdo transhi, Banka duhet, nëse kërkesa relevante për disbursim është konform nenit 1.02B dhe gjithmonë subjekt i kushteve relevante të nenit 1.04, t’i dorëzojë Huamarrësit një njoftim (në vijim i quajtur “Njoftim disbursimi”), i cili duhet të specifikojë:

a) shumën e transhit dhe alokimi i tij te përfituesit përfundimtarë;

b) datën në të cilën transhi është përcaktuar për t’u disbursuar (në vijim e quajtur “Data e përcaktuar e disbursimit”);

c) përqindja e interesit e aplikueshme për transhin sipas neni 3.01;

d) datat e pagesës të aplikueshme për transhin;

e) termat e aplikueshme për shlyerjen;

duke marrë në konsideratë faktin që një ose shumë prej elementeve të specifikuara në njoftimin e disbursimit nuk është konform elementeve korresponduese, nëse ka të tilla në kërkesën e disbursimit, Huamarrësi mundet brenda tri ditësh gjatë të cilave bankat tregtare janë të hapura për kryerjen e aktiviteteve në Luksemburg (çdo ditë e tillë në vijim e quajtur “Dita e punës të Luksemburgut”), duke dorëzuar një kopje të njoftimit të disbursimit, të ndalojë kërkesën për disbursim duke njoftuar Bankën dhe si rrjedhojë e kësaj kërkesa e disbursimit dhe njoftimi i disbursimit nuk do të kenë më vlefshmëri.

D. Shuma e çdo transhi duhet të disbursohet nga Banka në llogarinë e Huamarrësit me Bankën e Shqipërisë si një oficer i autorizuar saktësisht i Huamarrësit. Ministria e Financave duhet të njoftojë Bankën jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë përpara datës së përcaktuar të disbursimit.

1.03 Monedha

Banka duhet të disbursojë çdo transh në euro.

1.04 Kushtet e disbursimit

A. Pa paragjykim kundrejt neneve të tjera për nenin 1.04, çdo disbursim sipas nenit 1.02 duhet të jetë subjekt i plotësimit të kushteve të mëposhtme të kërkuara nga Banka, më saktë që përpara ose në datën e kërkesës së parë për disbursim:

a) Banka duhet të ketë marrë një opinion ligjor të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë në gjuhën angleze ose të përkthyer në anglisht, që konfirmon:

i) që kjo kontratë është brenda qëllimit të Marrëveshjes së kornizës së punës të nënshkruar në 5 shkurt 1998 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës, që zbatimi i kësaj kontrate në emër të Huamarrësit është e autorizuar saktësisht nga një vendim i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, që dispozitat e saj janë në fuqi, janë efektive dhe që është e vlefshme, e lidhur dhe e plotfuqishme në Shqipëri në përputhje me termat e saj;

ii) që të gjitha miratimet kontrolluese dypalëshe janë siguruar në mënyrë që Huamarrësi të lejohet të marrë shumat e disbursuara në vijim, të shlyejë huanë dhe të paguajë interesat dhe të gjitha shumat e tjera sipas kësaj kontrate dhe që miratimet të vlejné për hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarive bankare, të cilat Huamarrësi do të drejtojë Bankën për të disbursuar kredinë.

b) Banka duhet të ketë marrë evidencën e autoritetit të personit ose personave të autorizuar për nënshkrimin e kërkesave të disbursimit, si dhe specimenin e firmës origjinale të këtij personi ose personave për të nënshkruar.

Përveç kësaj, nëse kërkesa e parë për disbursim është bërë përpara se Banka të ketë marrë evidencat që demonstrojnë në një mënyrë të kënaqshme që të gjitha kushtet e specifikuar në nenin 1.04A janë përmbushur, kërkesa për disbursim do të presupozohet që të jetë marrë nga ana e Bankës, në datën kur këto kushte janë përmbushur.

B. Disbursimet sa më poshtë të çdo transhi që nuk është transhi i fundit, do të jetë subjekt i sa më poshtë:

a) Banka, pas marrjes nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit të Huamarrësit, në/ose më përpara datës së kërkesës relevante për disbursim, të evidencës së përmendur në nenin 8.01(a)(i) në lidhje me transhin e mëposhtëm të menjëhershëm dhe;

b) Banka, duke qenë e mendimit që agregati i transhit të kërkuar dhe pjesët e të gjitha transheve të disbursuara më parë të alokuara nga Banka pranë përfituesve përfundimtarë, të cilën në datën e kërkesës relevante për disbursim (i) nuk janë në shkelje të garancisë, e dhënë në nenin 6.11 në marrëveshjen e huasë të nënshkruar midis tyre dhe (ii) përkojnë me sipërmarrjet e ndërmarra sipas neneve 6.02, 6.04, 6.05, 6.06, 6.07, 6.09, 6.10, 6.11, 6.13, 8.01 dhe 8.03, nuk do ta kalojnë shumën agregate të të gjitha shpenzimeve të kualifikuara të kryera nga përfituesit përfundimtarë deri në ditën që është 90 ditë nga data e kërkesës për disbursim.

Për qëllimet e kësaj kontrate në përgjithësi:

“Shpenzim i kualifikuar” nënkupton shpenzime (duke përjashtuar taksat dhe tarifat doganore të pagueshme në Shqipëri) të çdo përfituesi përfundimtar sipas një kontrate livrimi (duke përfshirë ndonjë amendament të miratuar nga Banka për këtë qëllim) sipas skemës së realizuar nga përfituesi përfundimtar.

“Përfituesi përfundimtar” nënkupton secilën nga të katër kompanitë e ujësjellës-kanalizimeve referuar në kapitullin e parë, kanë lidhur, sipas termave të kënaqshëm të Bankës, një Marrëveshje huaje dhe një ose më shumë kontrata livrimi, për një vlerë agregate minimale të njëjtë me 10% të kostos totale të investimit, siç është vlerësuar në këtë datë nga Banka në bazë të skemës së realizuar nga kompania e ujësjellës-kanalizimeve; përveç rastit të kompanisë së ujësjellës-kanalizimeve që operon në Korçë, pasi kjo kompani nuk është një përfitues përfundimtar, veç rastit kur Banka ka marrë nga Huamarrësi:

i) dokumente evidentuese që marrëveshjet ndërmjet Huamarrësit dhe BB/IDA dhe ato ndërmjet Huamarrësit dhe GEF-it për dhënie e fondeve të përcaktuara në kapitullin e 2-të në pozicionet (ii) dhe (v) janë përfunduar dhe janë efektive;

ii) dokumente që evidentojnë se përgjegjësia e plotë e koordinimit dhe e supervizionimit të kontratave të livrimit për skemat relevante i janë caktuar zyrtarisht PIU-t ekzistues, të financuara nga BB/IDA dhe të krijuara për projektin në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

“Kontratë livrimi” nënkupton një kontratë të nënshkruar në rregullsi, nga e cila Banka duhet të disponojë një kopje të vërtetë të noterizuar, zbatuar sipas termave të kënaqshëm për Bankën, duke pasur në konsideratë udhëzimet e prokurimit, edicioni i qershorit 2003 i Bankës për punime, mallra

apo shërbime, të prokuruar sipas një skeme të specifikuar në pikën 2 të përshkrimit teknik.

“Marrëveshje për asistencë teknike” nënkupton një marrëveshje për provizionin-nga një firmë konsulente ndërkombëtare, kualifikimet e së cilës, eksperiencia në inxhinierinë civile, si dhe termat e referencat duhet të jenë të kënaqshme për Bankën-e një asistence teknike për përgatitjen dhe supervizimin e kontratave të livrimit për skemat e realizuara nga kompanitë relevante ujësjellës-kanalizime; dhe që një marrëveshje e tillë të jetë në fuqi për periudhën e plotë deri në përfundimin e projektit.

C. Disbursimi i transhit final sa më poshtë, duhet të jetë subjekt i Bankës që ka marrë nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit të Huamarrësit, përpara ose në datën e kërkesës relevante për disbursim, dokumente që evidentojnë në një mënyrë të kënaqshme për Bankën që shuma e vlerës së disbursimit final dhe të gjitha vlerat e alokuara më përpara nga Banka pranë përfituesve përfundimtarë të cilët, në datën e kërkesës relevante për disbursim (i) nuk janë në shkelje të garancisë, e dhënë në nenin 6.11, në Marrëveshjen e huasë të nënshkruar midis tyre dhe (ii) përkojnë me sipërmarrjet e ndërmarra sipas neneve 6 dhe 8, nuk e kalojnë shumën agregate të të gjitha shpenzimeve kualifikuese të kryera nga përfituesit përfundimtarë.

E. Për llogaritjen e ekuivalentit të euros të shumave të shpenzuara, Banka duhet, vetëm nëse është rënë dakord ndryshe, të aplikojë kursin e shkëmbimit të aplikueshëm në ditën e 30-të përpara datës së njoftimit të disbursimit.

F. Nëse ndonjë pjesë e evidencave të dorëzuara nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit të Huamarrësit, sipas nenin 1.04B ose 1.04C nuk është e kënaqshme për Bankën, do të aplikohet fjalia e fundit e nenit 1.04A, vetëm nëse Banka jep miratimin për të disbursuar në mënyrë proporcionale më pak se shuma e kërkuar për transhin.

1.05 Shtyrja e disbursimeve

A. Banka duhet, sipas kërkesës së Huamarrësit, të shtyjë plotësisht ose pjesërisht disbursimin e ndonjë transhi, i cili ka qenë subjekt i një njoftimi disbursimi në një datë të specifikuar nga Huamarrësi që bie jo më shumë se gjashtë muaj nga data e përcaktuar e disbursimit. Në një rast të tillë, Huamarrësi duhet të paguajë një garanci për shtyrjen siç është përcaktuar në nenin 1.05B më poshtë. Çdo kërkesë për shtyrje do të ketë efektivitet në kuadër të një transhi, vetëm nëse është kryer të paktën shtatë ditë-pune në Luksemburg përpara se data e përcaktuar e disbursimit.

B. Nëse disbursimi i ndonjë transhi është shtyrë, Huamarrësi duhet, sipas kërkesës së Bankës, të paguajë një garanci mbi shumën në të cilën disbursimi është shtyrë. Një garanci e tillë do të rrjedhë që nga data e përcaktuar e disbursimit në datën aktuale të disbursimit ose, si të jetë rasti, deri në datën e anulimit të transhit në një përqindje të barasvlefshme me R1 minus R2, ku:

“R1” nënkupton përqindjen e interesit që do të aplikohet kohë pas kohe sipas nenit 3.01 dhe njoftimi relevant i disbursimit, nëse transhi është disbursuar në datën e përcaktuar të disbursimit;

dhe

“R2” nënkupton EURIBOR më pak se 0.125% (12.5 pikët bazë); me qëllim përcaktimin e EURIBOR në lidhje me nenin 1.05 B, periudhat relevante të dhëna në skedulin B duhet të jenë periudha pasardhëse të një muaji që fillon nga data e përcaktuar e disbursimit.

Për më tepër, garancia:

- i) nëse shtyrja e kalon një muaj në kohëzgjatje, duhet të jepet në fund të çdo muaji;
- ii) duhet të llogaritet duke përdorur konventën ditore të llogaritjes e aplikueshme për R1 dhe
- iii) ku R2 e kalon R1, atëherë duhet të vendoset në zero.

1.06 Anulimi dhe pezullimi

A. Huamarrësi, në çdo kohë, pas njoftimit të dhënë pranë Bankës, mund të anulojë, plotësisht ose pjesërisht dhe me efekt të menjëhershëm, pjesën e padisbursuar të kredisë. Megjithatë, njoftimi nuk duhet të ketë efekt mbi një transh, data e përcaktuar e disbursimit aktual të të cilit bie brenda 7 ditëve- pune në Luksemburg mbas datës së njoftimit.

Nëse Huamarrësi anulon një transh, duhet të paguajë një garanci për shumën e anuluar. Kjo garanci duhet të llogaritet në përputhje me nenin 4.02 B, sipas periudhës që nis që nga data (data e fillimit) që është data e përcaktuar e disbursimit e transhit ose, në rast të anulimit të një transhi të pezulluar, mbas datës së përcaktuar të disbursimit, data e njoftimit të anulimit, deri në datën e dhënë të

shlyerjes finale të saj. Për këtë qëllim, (i) referencat në nenin 4.02B në datën e shlyerjes duhet t'i referohet datës së fillimit, të dhënë në fjalinë paraardhëse dhe (ii) shuma e anuluar duhet të shtyhet për t'u disbursuar dhe ripaguar sipas një date të tillë fillimi.

B. Banka, me anë të njoftimit të Huamarrësit, mund të pezullojë plotësisht ose pjesërisht, pjesën e padisbursuar të kredisë në çdo kohë dhe me efekt të menjëhershëm:

a) sipas kushteve të përmendura në nenin 4.03 ose nenin 10.01 ose

b) nëse Banka, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, është e mendimit që një përfitues përfundimtar (i) është në shkelje të garancisë, e cila sipas nenin 6.11 përmbahet në marrëveshjen e nënhuasë të nënshkruar nga ai ose (ii) nuk përputhet me ndonjë sipërmarrje të dhënë sipas neneve 6 dhe 8;

c) nëse raste të veçanta do të bëhen aktuale, të cilat do të ndikojnë aksesin e Bankës për tregje kapitale relevante ndërkombëtare.

Pezullime të tilla do të vazhdojnë derisa Banka njofton Huamarrësin që mund të fillojnë derdhjet bankare për kredinë ose sipas rastit, deri sa Banka të anulojë shumat e pezulluara siç është dhënë më poshtë.

Për më tepër, Banka duke njoftuar Huamarrësin, mund të anulojë totalisht ose pjesërisht pjesën e padisbursuar të kredisë sipas kushteve të pikave (a) dhe (c) më sipër, në rast të nenit 4.03B ose nenit 10.01B subjekt i plotësimit të procedurave të specifikuara në këto nene. Megjithatë, Banka nuk duhet të jetë e emëruar për pezullimin apo anulimin e ndonjë transhi në bazë të përmbajtjes së pikës (c) të këtij neni.

C. Nëse Banka pezullon një transh mbi bazën e vetme të pikave (a) dhe (b) të nenit 1.06B, Huamarrësi duhet të paguajë një garanci mbi shumën e pezulluar, e llogaritur në mënyrat e dhëna për këtë gjë në nenin 1.05 B. Nëse Banka anulon një transh mbi bazën e vetme të dhënë në pikat (a) ose (b), Huamarrësi duhet të paguajë një garanci mbi shumën e anuluar, e llogaritur kjo në përputhje me nenin 1.06A, kur është vërtetuar që nuk është e pagueshme garancia për anulimin mbi bazën e vetme të një ngjarjeje të përmendur në nenin 4.03A ose 4.03B.

D. Banka, në çdo kohë mbas 31 janarit 2010, duke njoftuar Huamarrësin, mund të anulojë ndonjë pjesë të padisbursuar të kredisë.

Huamarrësi nuk ka si pasojë përgjegjësi garancie Bankës, ose e kundërta, për arsye të ndonjë anulimi në nenin 1.06D.

1.07 Monedha e garancisë

Shumat e Huamarrësit për Bankën sipas nenit 1, duhet të llogariten dhe të paguhën në euro.

Neni 2

Huaja

2.01 Shuma e huasë

Shuma e huasë e dhënë sa më poshtë (këtu e referuar si "Huaja") duhet të përfshijë shumat agregate të disbursuara nga Banka, në monedhën e euros, siç është njoftuar nga Banka pranë Huamarrësit, sipas rastit të disbursimit të çdo transhi.

2.02 Monedha e shlyerjeve

Çdo shlyerje e një transhi sipas nenit 4, ose sipas rastit, neni 10 duhet të jetë dhënë në euro.

2.03 Monedha e interesave dhe e detyrimeve të tjera

Pa paragjykim kundrejt nenit 4.04, interesat dhe detyrimet e tjera të pagueshme nga ana e Huamarrësit sipas nenit 3.01, nenit 4, ose ku është e aplikueshme, nenit 10, duhet të llogariten dhe të jenë të pagueshme në euro.

Çdo pagesë tjetër duhet të bëhet në monedhën e specifikuar nga Banka, duke pasur parasysh monedhën e shpenzimeve që janë për t'u rimbursuar me anë të kësaj pagese.

2.04 Njoftimi i Bankës

Mbas çdo disbursimi të një transhi, Banka duhet t'i dorëzojë Huamarrësit një përmbledhje vërtetimesh që tregojnë datën e disbursimit, shumën në euro, termat e shlyerjeve, përqindjet e interesit të këtij transhi dhe për këtë transh. Një konfirmim i tillë duhet të përfshijë dhe tabelën relevante të amortizimit që është përcaktuar në nenin 4.01.

Neni 3 Interesat

3.01 Përqindjet e interesit

Bilanci i dalë nga çdo transh duhet të mbajë interesat në përqindjen e specifikuar në njoftimin për disbursim që lidhet me të, përqindja e të cilit duhet të jetë përqindja e interesit e aplikueshme në datën e njoftimit të disbursimit për hua të dhëna në monedhën e transhit të dhënë nga Banka në përputhje me parimet e aplikueshme të dhëna kohë pas kohe nga organet qeverisëse të Bankës për huamarrës të ngjashëm, sipas termave të njëjta për pagesën e interesit, si transhi në fjalë.

Interesat duhet të jenë të pagueshme në periudha gjysmëvjetore me çdo datë pagimi të specifikuar në përmbledhjen përkatëse të vërtetimit të dorëzuar sipas nenit 2.04.

3.02 Interesat e shumave që u ka kaluar afati

Pa paragjykim të nenit 10 dhe duke përfshirë nenin 3.01, interesat duhet të përdoren në çdo shumë që i ka kaluar afati, të pagueshme sipas termave të kësaj kontrate, që nga data e përcaktuar deri në datën e pagesës në një përqindje vjetore të njëjtë me EURIBOR plus 2% (200 pika bazë) dhe duhet të jetë e pagueshme në përputhje me kërkesën e Bankës. Me qëllim që të përcaktohet EURIBOR në lidhje me nenin 3.02, periudhat përkatëse sipas kuptimit të skedulit B duhet të jenë periudha në vazhdimësi prej një muaji që fillojnë që nga data e përcaktuar për pagesë.

Megjithatë, interesat duhet të jepen sipas përqindjes së përcaktuar në nenin 3.01 plus 0,25% (25 pikë bazë), nëse përqindja e mëvonshme e kalon afatin, për ndonjë periudhë të dhënë përkatëse, do të përdoret përqindja e specifikuar në paragrafin e mëposhëm.

Nëse shuma që e ka kaluar afatin është në një monedhë të ndryshme nga euro, përqindja vjetore e aplikuar, do të jetë përgjithësisht e mbajtur nga Banka për transaksione në këtë monedhë, e llogaritur në përputhje me praktikën e tregut për një përqindje të tillë, plus 2% (200 pikë bazë).

Neni 4 Shlyerja

4.01 Shlyerja normale

Huamarrësi duhet të shlyejë çdo transh në bazë të parimit gjysmëvjetor mbi datat e pagesës të specifikuar në përmbledhjet përkatëse të vërtetimeve të dorëzuara sipas nenit 2.04 në përputhje me termet e grafikut të shlyerjes së specifikuar (grafik i cili do të jetë pjesë e kësaj kontrate).

Data e parë e shlyerjes e aplikueshme për çdo transh duhet të jetë brenda 6 ½ vitesh, brenda datës së disbursimit të tij dhe data e shlyerjes së fundit të tij duhet të jetë jo më pak se 4 vjet ose jo më shumë se 20 vjet nga kjo datë.

4.02 Shlyerja vullnetare

A. Subjekt i paragrafit B më poshtë, Huamarrësi mund të shlyejë para kohe të gjithë ose pjesë të ndonjë transhi, së bashku me interesat që rrjedhin prej saj, duke dhënë një njoftim me shkrim një muaj më përpara (në vijim i quajtur njoftim i parapagimit) që do të specifikojë shumën që do të parapaguhet (shuma e parapagimit) dhe datën kur Huamarrësi propozon të kryejë parapagimin (data e parapagimit), datë e cila do të jetë një ditë pagimi për këtë transh.

B. Sipas çdo shume të parapagimit të një transhi, Huamarrësi duhet t'i paguajë Bankës në datën e parapagimit një garanci të barasvlefshme me vlerën prezente (si në datën e parapagimit) për përshpejtim, nëse ka;

i) të interesit që do të përdoret mbi shumën e parapagimit që nga data e parapagimit deri në ditën finale të dhënë të ripagimit të saj, nëse nuk është parapaguar, mbi

ii) të interesin që do të përdoret, nëse është llogaritur sipas përqindjes së zhvendosjes të BEI-t, që është efektive një muaj përpara datës së ripagimit, minus 15 pikë bazë.

Në këtë kontratë, “përqindja e zhvendosjes e BEI-t” nënkupton përqindjen standarde të interesit të Bankës për hua me përqindje fikse interesi, të përcaktuara në euro, që kanë profilin e njëjtë të shërbimit të debitit kundrejt maturitetit përfundimtar, si shuma e parapagesës.

Vlera prezente e thënë duhet të llogaritet me një përqindje të ulur të barasvlefshme me përqindjen e zhvendosjes së BEI-t e aplikuar sipas çdo date pageje relevante.

C. Banka duhet të njoftojë Huamarrësin, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parapagesës, së shumës së parapagimit, të interesave sipas kësaj shume dhe, në rast të parapagimit të një transhi, edhe e garancisë së pagueshme sipas nenit 4.02 B më sipër, ose sipas rastit, që nuk është për t'u paguar garanci.

Jo më vonë se ora 17.00 sipas orës së Luksemburgut, ditën e marrjes së një njoftimi të tillë (ose 17.00 e ditës së mëpasshme, nëse njoftimi është dorëzuar më vonë se ora 12.00 me orarin e Luksemburgut), Huamarrësi duhet të njoftojë Bankën ose:

- i) që konfirmon njoftimin e parapagesës sipas termave të specifikuar nga Banka; se
- ii) që po tërheq njoftimin e parapagesës.

Nëse Huamarrësi jep konfirmimin sipas pikës (i), atëherë do të preket parapagimi. Nëse Huamarrësi tërheq njoftimin e parapagimit ose dështon të japë konfirmimin në kohën e saktë, nuk do të preket parapagimi. Sa më i lartë është thënë, njoftimi i parapagimit në këto raste është lidhës dhe i pakthyesëm.

4.03 Parapagimi i detyrueshëm

A. Nëse kostoja totale e projektit është në mënyrë të konsiderueshme nën shumën e dhënë në kapitujt, Banka, në raport me koston e re, mund të kërkojë parapagimin e huasë.

B. Nëse Huamarrësi parapaguan vullnetarisht një pjesë ose të gjithën e ndonjë huaje të kontraktuar fillimisht sipas një kushti për më shumë se 5 vjet, Banka mund të kërkojë parapagimin e një raporti të tillë të shumës së huasë që është e hapur, pasi shuma e parapaguar hyn në shumën agregate të dalë, të të gjitha huave të tilla.

Banka duhet t'ia adresojë kërkesat e saj, nëse ka, Huamarrësit brenda katër javëve mbas marrjes së njoftimit përkatës sipas nenit 8.02(a). Çdo shumë e kërkuar nga Banka duhet të paguhet në datën e caktuar nga Banka, e cila nuk duhet të jetë përpara datës së shlyerjes së ndonjë huaje tjetër të tillë.

Parapagimi i një huaje me anë të termave të një huaje të re që ka një kohëzgjatje prej të paktën sa kohëzgjatja e papërfunduar e huasë së parapaguar nuk duhet të konsiderohet si një parapagesë.

C. Nëse përpara aplikimit të nenit 1.04C të kësaj kontrate, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, nuk do të tërhiqen transhe të tjera, Huamarrësi duhet të parapaguajë sipas kërkesës, pjesë të huasë që del nga shpenzimet kualifikuese. Çdo shumë e tillë që do të kërkohej nga Banka do të paguhet në datën e përcaktuar nga ajo.

D. Nëse Huamarrësi informon Bankën sipas nenit 8.02 pika (b), që ka ndodhur një ndryshim i kontrollit të ngjarjes ose ka shumë ngjasa të ndodhë, ose Banka ka arsye të besojë që një ndryshim i tillë i kontrollit të ngjarjes ka ndodhur ose do të ndodhë, Banka mund t'i kërkojë Huamarrësit që të konsultohet për këtë gjë. Një konsultim i tillë duhet të kryhet brenda tridhjetë ditësh nga data e kërkesës së Bankës. Me kusht që për qëllimet e "ndryshimit të kontrollit të ngjarjes" marrja e një personi fizik apo ligjor, ose e një grupi të personave të tillë që veprojnë bashkërisht, është ligjore dhe ka fuqinë për të caktuar dhe/ose për të hequr të gjithë ose një maxhorancë të anëtarëve të bordit të drejtorëve ose institucione të tjera qeverisëse të ndonjë përfituesi përfundimtar, nga ushtrimi ose jo i të drejtave të votës së palëve në mbledhjen e përgjithshme të një përfituesi të tillë përfundimtar dhe/ose të ndonjë personi tjetër ligjor.

Nëse, mbas një (i) kapërcimi fillestar prej tridhjetë ditësh nga data e kërkesës së Bankës dhe (ii) shfaqjes fillestare të ndryshimit të kontrollit të ngjarjes, Banka është e mendimit që një ndryshim i tillë i kontrollit të ngjarjes ka, ose ka shumë ngjasa të ketë një efekt material adversiv mbi shërbimet e ardhshme të huasë, Banka mund t'i kërkojë Huamarrësit të parapaguajë porcionin e shumës së huasë së mbetur pa paguar, pasi bilanci i huasë së papaguar sipas marrëveshjes së nën-huasë ndërmjet Huamarrësit dhe përfituesit përkatës përfundimtar hyn në shumë agregate të mbetur të të gjitha huave të kryera sipas marrëveshjeve të nënhuave. Parapagimi duhet të bëhet së bashku me interesat e dala dhe një shumë e formës së garancisë, nëse ka, e llogaritur në përputhje me nenin 4.02B për çdo transh për t'u parapaguar. Huamarrësi duhet të kryejë pagesën e shumës së kërkuar në datën e përcaktuar nga Banka, datë që bie jo më shumë se tridhjetë ditë nga data e kërkesës.

E. Paga sipas nenit 4.03 duhet të bëhet së bashku me interesat e mbledhura dhe një garanci të llogaritur në përputhje me nenin 4.02B mbi çdo transh për t'u parapaguar, nëse ka.

4.04 Kushtet e përgjithshme, përsa i përket parapagesës, sipas nenin 4

Në rast të pagesës së pjesshme të një transhi, shuma e parapaguar do të aplikohet në reduktimin *pro rata* të secilës prej shumave të konsideruara të paguara.

Neni 4 nuk do të cenojë nenin 10.

Neni 5 **Pagesat**

5.01 Vendi i pagesës

Çdo shumë do të paguhet nga Huamarrësi në këtë kontratë në llogarinë e caktuar nga Banka.

Banka duhet t'i saktësojë Huamarrësit jo më vonë se 15 ditë para datës së pagesës së parë nga Huamarrësi dhe do të njoftojë për çdo ndryshim të llogarisë jo më pak se 15 ditë para datës së pagesës së radhës. Kjo periudhë njoftimi nuk aplikohet në rast të një pagese që kryhet sipas nenit 10.

5.02 Llogaritja e pagesës sipas periudhave vjetore

Çdo shumë e detyruar që i referohet një interesi, komisioni apo diçkaje tjetër si më poshtë, që llogaritet sipas një periudhe të vitit, do të llogaritet në bazë të një viti me 360 ditë dhe një muaji me 30 ditë.

5.03 Datat e pagesës

Shumat që paguhen në bazë 6-mujori sipas çdo transhi, në përputhje me deklaratën përkatëse të dhënë në zbatim të nenit 2.04, duhen bërë në 15 mars dhe 15 shtator (çdo datë që këtej e tutje do të quhet "Data e pagesës").

Për arsye të kësaj kontrate në përgjithësi, detyrimet në euro për një datë e cila nuk është "ditë-pune" (d.m.th. në të cilën kryhen transfertat ndëreuropiane) janë të pagueshme në ditën e mëpasshme të punës.

Vetëm në rast se shprehet ndryshe në këtë kontratë, shumat për t'u paguar sipas kësaj kontrate, përjashtuar principialin apo interesin, janë të pagueshme brenda 7 ditësh nga marrja e kërkesës së Bankës nga Huamarrësi.

Një shumë për t'u paguar nga Huamarrësi do të quhet e paguar vetëm kur është futur në llogarinë e Bankës të caktuar sipas nenit 5.01.

Neni 6 **Dispozita të veçanta**

6.01 Përdorimi i huasë apo i fondeve të tjera

Huamarrësi do të përdorë fondet e huasë ekskluzivisht për financimin sipas marrëveshjeve të nënhuasë për ekzekutimin e skemave dhe sipas këtyre marrëveshjeve të detyrojë çdo përfitues përfundimtar të përdorë këto procedura të huasë, si dhe fondet e përmendura në kapitullin 2 që i janë dhënë atij nga Huamarrësi, me qëllim ekzekutimin e skemës.

6.02 Përfundimi i projektit

Huamarrësi, në marrëveshjen përkatëse të nënhuamarrjes, do të detyrojë çdo përfitues përfundimtar për të siguruar që skema përkatëse do të zbatohet në përputhje me, dhe do të kompletohet progresivisht gjatë periudhës së specifikuar në përshkrimin teknik, siç mund të modifikohet herë pas here me pëlqimin e palëve në këtë kontratë.

6.03 Kostot e rritura të projektit

Në rast se kostoja e projektit kapërcen shumën e specifikuar në kapitullin 2, Huamarrësi duhet të japë siguri në lidhje me gjetjen e financimit për të mbuluar hendekun, pa i paraqitur rekurs Bankës, në mënyrë që të sigurohet përfundimi i plotë i projektit dhe sipas skemës teknike të specifikuar. Planet e Huamarrësit për financimin e kostove shtesë duhen dorëzuar pranë Bankës për informacion në një kohë sa më të shpejtë.

6.04 Procedurat e tenderimit

Huamarrësi duhet, në përputhje me marrëveshjen e huasë, të detyrojë çdo përfitues përfundimtar:

a) që të blejë pajisje, të sigurojë shërbime dhe të urdhërojë punime sipas skemës dhe në përputhje me kërkesat e Bankës, dhe në formën e tenderit të hapur ndërkombëtar për kompanitë e të gjitha vendeve, në përputhje me guidën për prokurime të Bankës, botim i qershorit 2003;

b) që të paraqesë të gjitha dokumentet e tenderit për aprovim pranë Bankës.

6.05 Sigurimi

Huamarrësi, sipas marrëveshjes së nënhuasë, duhet të detyrojë çdo përfitues përfundimtar që të gjitha punimet t'i kryejë tërësisht dhe brenda parametrave të kërkuar për punime të këtij tipi.

Mirëmbajtja

6.06 Huamarrësi, sipas marrëveshjes së nënhuasë duhet të detyrojë çdo përfitues përfundimtar për mbajtjen, riparimin, kontrollin, rigjenerimin e aseteve që janë pjesë e skemës, në mënyrë që skema të funksionojë sipas parametrave.

6.07 Operimi i skemave

Huamarrësi në marrëveshjen përkatëse të nënhuasë, duhet të detyrojë çdo përfitues përfundimtar të mbajë titullin dhe zotërimin e aseteve që përbëjnë skemën e realizuar nga përfituesi final, të zëvendësojë dhe të rinovojë asete të këtyra dhe të mirëmbajë një skemë të tillë në operim të vazhdueshëm, në përputhje me qëllimin e punës, në çdo rast përsa kohë që huaja s'është paguar dhe përsa kohë që Banka nuk ka dhënë miratimin me shkrim.

Banka mund të mos e japë miratimin e saj vetëm kur veprimi i propozuar bie në kundërshtim me interesin e Bankës si huadhënëse ndaj Huamarrësit ose që mund të shkaktojë që skema të humbasë vlefshmërinë për financimin e Bankës.

6.08 Njësia e zbatimit të projektit

Huamarrësi do të mbajë, gjatë zbatimit të skemave në Durrës dhe Sarandë, si dhe në Lezhë e Shëngjin, një njësi të zbatimit të projektit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit. PIU:

a) do të pajiset siç duhet me pajisje dhe staf sipas kërkesave të Bankës;

b) do të besohet me zbatimin e koordinimin e këtyre skemave me mbështetjen e një firme konsultimi të kontraktuar sipas nenit 6.09, i cili do të mbulojë të gjitha fazat e zbatimit të tri skemave të përmendura më sipër, përfshirë përgatitjen e një projekti, dizenjot dhe dokumentet e tenderit, vlerësimin e tenderit dhe përzgjedhjen e fituesve, dhënien e kontratës, si dhe menaxhimin në supervizionimin e punimeve;

c) do të raportojë drejtpërdrejt te Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe do të përgjigjet vetëm para tij;

d) do të mbajë një sistem menaxhimi të financës sipas kërkesave të Bankës;

e) do të veprojë si kontrapart i Bankës në të gjitha çështjet teknike, administrative dhe raportuese që kanë të bëjnë me skemën.

Për qëllim sqarimi, Banka konfirmon se nuk kërkon që PIU të marrë përsipër detyrime apo punë që kanë të bëjnë me skemën për qytetin e Korçës, i cili do të përmbushë vetë detyrimet dhe përgjegjësitë.

6.09 Asistenca teknike

Huamarrësi:

a) do të hyjë në një ose më shumë marrëveshje AT për skemat që do të kryhen në Durrës dhe Sarandë, si dhe për Lezhën e Shëngjinin;

b) do të detyrojë, me anë të marrëveshjeve të huasë, përfituesin final që do të kryejë skemën në Korçë për të hyrë në një ose më shumë marrëveshje për asistencë teknike;

c) nuk do të disbursojë asnjë fond drejt përfituesit përfundimtar pa pasur më parë një marrëveshje për AT (asistencë teknike) sipas skemës së realizimit;

d) do të sigurojë që Banka, në çdo kohë, mund të verifikojë direkt nëpërmjet konsulentit me të cilin është nënshkruar një marrëveshje për AT.

“Marrëveshje AT” do të thotë marrëveshje për sigurimin, nëpërmjet konsulentëve ndërkombëtarë, firmë kualifikimi i së cilës, eksperiencia në punime civile dhe terma reference sipas kritereve të Bankës, asistencë teknike për përgatitjen e supervizionin e kontratave të furnizimit, ndaj sipas skemës së qytetit të Korçës ose skemave të kryera nga përfitues të tjerë përfundimtarë.

6.10 Marrëveshje për ambientin

Huamarrësi do të detyrojë sipas marrëveshjes çdo përfitues përfundimtar, përsa kohë është në fuqi huaja e pashlyer:

a) të zbatojë, të operojë skemën e bërë nga përfituesi përfundimtar, në përputhje me standardet për mjedisin të BE-së dhe praktikat shqiptare për ruajtjen, mbrojtjen e mjedisit dhe që përfshijnë

kushtet ligjore që bëjnë efektive marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mjedisin, ku me mjedis kuptohet sa më poshtë:

1. flora dhe fauna,
2. dheu, uji, ajri, klima dhe peizazhi,
3. mjedisi dhe trashëgimia kulturore.

b) të sigurojë dhe të marrë të gjitha aprovimet, autorizimet nga organet kompetente mjedisore në Shqipëri për arsyet e përmendura në paragrafin e mësipërm (a);

c) të sigurojë që skema është zbatuar dhe nuk do të ketë efekte negative në konservimin e natyrës dhe të sigurojë që s'janë përdorur substanca apo materiale që mund të kenë efekte negative në mjedis apo hedhur gjatë ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së skemës;

d) të kryejë gjithë mirëmbajtjen dhe punimet rehabilituese sipas skemës, që mund të kërkohej nga organet kompetente mjedisore.

6.11 Angazhimi i integritetit

Huamarrësi, bazuar në marrëveshjen e nënhuasë, të detyrojë çdo përfitues përfundimtar, të garantojë dhe ndërmarrë në interes të huadhënësit dhe Bankës që ai nuk ka kryer, dhe asnjë person që dihet të ketë kryer, ndonjë prej akteve të mëposhtme dhe që nuk do të kryejë, dhe asnjë person, me miratimin e tij apo njohje të tij, do të kryejë një veprim si:

- Ofrimi, dhënia, marrja përsipër e një favorit për të influencuar veprimin e ndonjë personi me post publik, apo drejtori apo zyrtari të ndonjë institucioni publik, apo drejtori apo zyrtari nga ndonjë organizatë ndërkombëtare në lidhje me ndonjë etapë të prokurimit apo gjatë zbatimit të ndonjë kontrate që ka të bëjë me projektin; ose

- Ndonjë akt që në mënyrë të padrejtë influencon apo synon të influencojë procesin e prokurimit apo gjatë zbatimit të projektit në kurriz të përfituesit përfundimtar, përfshirë dhe përplasjen mes tenderuesve.

Për këtë qëllim, njohja e çdo personi të bordit mbikëqyrës apo drejtori ekzekutiv që ka të bëjë me përfituesit përfundimtarë, do të konsiderohet njohje e përfituesit përfundimtar. Huamarrësi merr përsipër të informojë Bankën në rast se ka informacione që kanë të bëjnë me këto akte.

6.12 Përgjegjësitë e bashkive

Huamarrësi do të bëjë ç'është e mundur që të sigurojë që këshilli i rrethit të Durrësit dhe bashkitë e Sarandës, Lezhës, Shëngjinit dhe Korçës do të prezantojnë dhe bashkëfirmosin një master plan për kanalizimet, që të jetë i pëlqyeshëm për Bankën.

Huamarrësi do të përpiqet për të siguruar që këshilli i rrethit të Durrësit dhe bashkitë e Sarandës, Lezhës, Shëngjinit dhe Korçës të rregullojnë nivelin dhe strukturën e tarifave të ujit dhe të kanalizimeve, si dhe politikën e grumbullimit të tarifave sipas kërkesave të Bankës, në mënyrë që, duke filluar nga 2007, të paktën kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes të përfituesit përfundimtar në territorin e tij të jenë të mbuluara.

6.13 Marrëveshje speciale me përfituesit përfundimtarë

Huamarrësi, në përputhje me marrëveshjen e huasë, do të detyrojë çdo përfitues përfundimtar që të arrijë deri në vitin 2007 mbulim të plotë nëpërmjet tarifave të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes.

6.14 Interesat që aplikohen mbi përfituesit përfundimtarë

Huadhënësi do të aplikojë interes mbi balancën herë pas here mbi çdo shumë të disbursuar sipas marrëveshjes së huasë me një përqindje interesi vjetor të barabartë me 2/5 (dy të pestat) e përqindjes për vit të aplikuar nga Banka sipas transhit, nga i cili është financuar shuma përkatëse.

Neni 7

Siguria

7.01 Siguria

Në qoftë se Huamarrësi do t'ia kalojë sigurinë mbi përmbushjen e detyrimeve të borxhit të jashtëm një pale të tretë ose prioritet apo përparësi, Huamarrësi duhet që më parë të informojë Bankën dhe, në qoftë se kërkohej nga kjo e fundit, të sigurojë pranë saj garanci të njëvlefshme për përmbushjen e detyrimeve të tij Bankës ose një preferencë apo prioritet të njëvlefshëm.

Huamarrësi paraqet se asnjë interes për sigurinë, preferencë apo prioritet s'ekziston.

Neni 8

Informacioni dhe vizitat

8.01 Informacion mbi projektin dhe përfituesit përfundimtarë

Huamarrësi do të sigurojë që:

a) Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit do t'a dorëzojë Bankës dokumentet e mëposhtme, të përgatitura në bashkëpunim me firmën konsultuese të përmendur në nenin 6.09, në anglisht apo të përkthyer në anglisht:

i) Brenda 90 ditëve nga disbursimi i çfarëdo transhi, përjashtuar atë final, të sigurojë prova pranë Bankës, certifikuar nëpërmjet PIU-t (përveç rastit të Korçës) dhe firmës konsulente, në mënyrë që shuma agregate e transhit përkatës dhe pjesë të transheve të mëparshme të disbursuara, të alokuara nga Banka drejt përfituesve përfundimtarë, të cilët në ditën e kërkesës për disbursim për atë transh, të përmbushë kriterin e vënë në nenin 1.04 B nuk e kalon shumën totale të shpenzimeve kualifikuese të lindura nga përfituesit finalë.

ii) Në bazë 6-mujori për Korçën dhe 2-mujori për skemat e tjera, deri në kompletimin e skemës apo skemave, një raport zbatimi çohet te financuesit për skemën apo skemat, çdo raport duhet të jetë sipas formatit dhe të përmbajë indikatorët e performancës, të pranuar nga Banka.

iii) Herë pas here, çdo dokument shtesë apo informacion që ka të bëjë me financimin dhe zbatimin e projektit siç mund të kërkohej prej Bankës.

iv) Brenda 6 muajve pas kompletimit të projektit, një raport për përfundimin e projektit;

b) Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit:

i) pa vonesë, do të paraqesë për aprovim pranë Bankës çdo ndryshim në planet e përgjithshme, grafikët, planet financiare apo plane shpenzimesh për çdo skemë, që ka të bëjë me synimet e Bankës para firmosjes së kësaj kontrate;

ii) do të mbajë rekorde që në çdo kohë të tregojnë operacionet e Huamarrësit sa herë që e kërkon Banka;

iii) do të mbajë të dhënat të cilat do të tregojnë në çdo kohë aktivitetin e Huamarrësit mbi financimin dhe ekzekutimin e projektit;

iv) do të informojë Bankën:

- menjëherë sapo të njoftojë, të besojë apo, siç mund të jetë rasti, baza për të besuar që në rastin e ndryshimit të kontrollit ka ndodhur ose do të ndodhë, një informacion i tillë do të komunikohet sa më shpejt Huamarrësi të ketë arsye të besojë kështu;

- në kohën e duhur për çdo situatë që kërkon miratimin e Bankës sipas nenit 6.07;

- në përgjithësi për çdo fakt apo ngjarje të njohur prej Huamarrësit që mund të ndikojë drejtpërdrejt në zbatimin e operimin e projektit.

c) çdo përfitues përfundimtar do të ndërmarë sipas marrëveshjes së nënshkruar prej tij:

i) të mbajë, në një vend të caktuar, për inspektim nga Huamarrësi dhe Banka deri në kapërcimin e një periudhe 6-vjeçare nga mbyllja e çdo kontrate furnizimi, termat e plotë të kontratës së furnizimit në vetvete, si dhe materialet që kanë të bëjnë me procesin e prokurimit dhe me zbatimin e kontratës së furnizimit;

ii) të sigurojë që Huamarrësi dhe Banka të mund të inspektojnë dokumentet kontraktuale, të cilat kontraktori ka detyrim t'i ketë në bazë të kontratës së furnizimit.

8.02 Informacion mbi Huamarrësin

Huamarrësi do të informojë Bankën:

i) menjëherë për çdo vendim të marrë prej tij për cilëndo arsye, për çdo fakt që përbën detyrim për të dhe për çdo kërkesë të bërë prej tij për shlyerjen para kohe të çdo huaje;

ii) menjëherë, të çdo qëllimi të tij për të krijuar interes sigurie mbi cilindo prej aseteve të tij në favor të një pale të tretë për zbatimin e çdo detyrimi të tij të jashtëm ose çdo preference apo prioriteti në lidhje me to;

iii) përgjithësisht për çdo fakt apo ngjarje që mund të mos lejojë plotësimin e detyrimeve të Huamarrësit në bazë të kësaj kontrate.

8.03 Vizitat

Huamarrësi sipas marrëveshjes, do të detyrojë çdo përfitues përfundimtar që të lejojë çdo person të caktuar prej Bankës, që mund të shoqërohet prej përfaqësuesve të Gjykatës së Auditorëve të BE-së, të vizitojë vendet, instalimet dhe punimet që përmban projekti dhe të kryejë verifikime sipas

dëshirës. Për këtë arsye, Huamarrësi do të sigurojë për këta vizitorë gjithë asistencën e nevojshme.

8.04 Investigimi dhe informacioni

Huamarrësi ndërmerr dhe do të detyrojë në marrëveshjen e huasë të gjithë përfituesit përfundimtarë:

- a) të ndërmarrin veprime të kërkuara nga Banka për investigimin dhe/ose ndërprerjen e çdo akti të dyshuar apo të pretenduar të natyrës së akteve të përcaktuara në nenin 6.11;
- b) të informojë Bankën për masat e marra për dëmshpërblim nga personat e përgjegjshëm për humbje që janë pasojë e këtyre akteve;
- c) të lehtësojnë investigimet që Banka mund të bëjë në lidhje me këto akte.

Neni 9

Taksa dhe shpenzime

9.01 Taksat, tatimet dhe detyrimet

Huamarrësi duhet të paguajë të gjitha taksat, tatimet, detyrimet dhe çdo obligim tjetër të çfarëdo natyre, përfshirë këtu dhe detyrimin e vulës dhe taksën e regjistrimit, të dala nga ekzekutimi dhe zbatimi i kësaj kontrate apo dokumenti tjetër që ka të bëjë me të dhe në krijimin e garancive për huanë. Huamarrësi do të paguajë të gjithë principalin, interesat, komisionin dhe shumën të tjera të detyrueshme në bazë të kontratës pa zbritjen e asnjë detyrimi kombëtar apo lokal. Në rastin kur, nëse Huamarrësi është i detyruar me ligj të bëjë këto zbritje, ai do të plotësojë pagesën e Bankës në mënyrë që dhe pas zbritjes shumën në të marrë nga Banka të jetë e barabartë me shumën e detyruar.

9.02 Taksa të tjera

Huamarrësi do të përballojë të gjitha shpenzimet profesionale, bankare, transferat apo të shkëmbimit të dala gjatë zbatimit të kësaj kontrate dhe dokumenteve të tjera të lidhura me të, si dhe shpenzimet në lidhje me krijimin e garancive për huanë.

Neni 10

Parapagesa mbi një rast mospagese

10.01 E drejta për të kërkuar shlyerje

A. Huamarrësi do të shlyejë huanë ose ndonjë pjesë të saj menjëherë pasi të marrë kërkesën e tillë nga Banka:

a) Çdo informacion apo dokument çuar Bankës nga ose në emër të Huamarrësit, në lidhje me negociimin e kësaj kontrate apo gjatë kohëzgjatjes së saj, provohet që të ketë qenë jokorrekte në lidhje me ndonjë material në veçanti.

b) Nëse Huamarrësi nuk shlyen në datën e duhur pjesë të huasë, interesat ose t'i kryejë pagesa të tjera Bankës siç parashikohet në këtë Marrëveshje.

c) Nëse Huamarrësi dështon në plotësimin e detyrimeve financiare në lidhje me huatë (të ndryshme nga huaja) e dhëna nga Banka apo Komuniteti Europian, dhe nëse, kur ka mospagim në kohë në lidhje me to, Huamarrësi është i detyruar të parapaguajë çdo hua tjetër apo të shlyejë përpara maturitetit çdo borxh të dalë nga veprime financiare.

d) Nëse Huamarrësi apo çdonjëri nga përfituesit përfundimtarë dështojnë në përmbushjen e çdo detyrimi në lidhje me çdo hua apo grant të referuar në kapitullin e dytë, e drejta e Huamarrësit për të tërhequr shumën e parashikuar nga huaja apo granti, tërësisht apo pjesërisht, hiqet ose anulohet, ose nëse huaja apo granti bëhet i kthyeshëm sipas kushteve të tij.

e) Nëse krijohen situata apo ngjarje të cilat mund të rrezikojnë procedurën e livrimit të huasë apo që ndikojnë negativisht sigurinë e dhëna për të.

B. Huamarrësi do të shlyejë huanë ose pjesë të saj me kërkesë të Bankës pas përfundimit të një periudhe të arsyeshme kohore të përcaktuar në një njoftim dërguar Huamarrësit nga Banka:

a) Nëse Huamarrësi dështon në përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë, përveç detyrimit të pagimit të përcaktuar në nenin 10.01A(b).

b) Nëse kushtet apo faktet e përcaktuara në përshkrimet vërtetohen të jenë të gabuara, ndryshojnë konsiderueshëm apo pushojnë së qeni dhe kjo ka pasoja negative për interesat e Bankës si Huadhënësi apo prekin negativisht zbatimin apo ecurinë e projektit.

10.02 Të tjera të drejta ligjore

Neni 10.01 nuk duhet të kufizojë të drejta të tjera të Bankës për të kërkuar parapagimin e huasë.

10.03 Kompensimi

Në rastin e një kërkesë në bazë të nenit 10.01, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një shumë të llogaritur në përputhje me procedurat e përcaktuara nga neni 4.02B mbi shumën e çdo transhi, të cilët i ka ardhur koha dhe është bërë i pagueshëm. Kjo shumë do të llogaritet mbi bazën që parapagesa është bërë në datën e duhur të përcaktuar në fletëkërkesën e Bankës.

10.04 Mosheqja dorë nga të drejtat

Asnjë dështim apo vonesë e Bankës në ushtrimin e çdo të drejte të saj në bazë të nenit 10 nuk duhet të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë.

10.05 Përdorimi i shumave të marra

Shumat e marra në vijim të kërkesës në bazë të nenit 10 do të përdoren së pari për pagimin e dëmeve, komisioneve dhe interesave në këtë rend dhe së dyti për zvogëlimin e kësteve tepër të mëdha sipas maturitetit në rend të kundërt. Ato do të zbatohen ndërmjet transheve me pëlqimin e Bankës.

Neni 11

Ligji dhe juridiksioni

11.01 Ligji

Kjo kontratë u nënshtrohet ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut.

11.02 Juridiksioni

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me këtë kontratë do t'i dorëzohen Gjykatës së Drejtësisë të Komunitetit European në Luksemburg.

Palët në kontratë heqin dorë nga çdo imunitet apo e drejtë për të kundërshtuar juridiksionin e kësaj gjykate. Vendimi i gjykatës i dhënë në përputhje me këtë nen 11.02 është i prerë dhe i detyrueshëm për palët pa kufizime ose rezerva.

11.03 Prova e shumave të detyruara

Në çdo veprim ligjor që del nga kjo kontratë, certifikata e Bankës që përcakton shumën që i detyrohet Bankës në bazë të kësaj kontrate do të jetë provë *prima facie* e kësaj shume.

Neni 12

Dispozita të fundit

12.01 Njoftime

Njoftime apo komunikime të tjera të dhëna më poshtë do të dërgohen në adresat e dhëna më poshtë, përveç njoftimeve për Huamarrësin në lidhje me litigimin, qoftë pezullues apo kërcënues, do të dërgohen në adresën e dhënë në numrin (2) më poshtë, atje ku Huamarrësi kërkon vetë.

- Për Huamarrësin:

1. Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
Albania
2. Misioni i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin
European
Rue Tenbosch 30
B-1000 Bruksel

100, Boulevard Konrad Adenauer
L-2950 Luksemburg

- Për Bankën

Secila palë, duke njoftuar tjetrën, mund ta ndryshojë adresën (at) e saj të dhënë më sipër, por adresa e dhënë në pikën (2) mund të ndryshohet vetëm me një adresë tjetër brenda Bashkimit European.

12.02 Komunikime mbi çështje të integritetit

Përveç nëse Huamarrësi specifikon ndryshe me shkrim për Bankën, Drejtori i Njësisë së Monitorimit dhe Koordinimit të Projekteve i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit të Huamarrësit ka kompetencën e kontakteve me Bankën për qëllimet e nenit 6.11.

12.03 Forma e njoftimit

Njoftimet dhe komunikime të tjera, për të cilat kjo kontratë përcakton periudhën kohore apo ato vetë përcaktojnë periudha kohore të detyrueshme për marrësin, do të dorëzohen me dorë, postë të regjistruar, telegram, teletekst apo mënyra të tjera dërgimi, të cilat japin prova të marrjes së saj nga marrësi. Data e regjistrimit apo, si dhe mund të jetë rasti, data e përcaktuar si data e marrjes së njoftimit do të jetë e vlefshme për përcaktimin e periudhës kohore.

12.04 Kapitujt dhe anekset

Raportet dhe anekset A (Përshkrimi teknik) dhe B(EURIBOR) janë pjesë e kësaj kontrate.

Në dëshmi të sa më sipër, palët në këtë kontratë nënshkruajnë kontratën në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.

Luksemburg, 22 dhjetor 2003

Nënshkruar për dhe në emër të Republikës
së Shqipërisë
Artur Kuko

Nënshkruar për dhe në emër të Bankës Europiane
të Investimeve
D.R.R Dunnett P.Walsh

SHTOJCA A
PËRSHKRIMI TEKNIK
PROJEKTI I INFRASTRUKTURËS UJORE BASHKIAKE
(SHQIPËRIA)

1. Objektivi

Objektivi kryesor i projektit është rehabilitimi, përmirësimi dhe shtrirja e rrjetit të ujësjellës - kanalizimeve për bashkitë bregdetare të Durrësit, Lezhës, Shëngjinit, Sarandës dhe bashkisë së Korçës në Shqipëri. Projekti mbështet ristrukturimin institucional të qyteteve bregdetare nëpërmjet dhënies së një kontrate menaxhimi pesëvjeçare një operatori privat.

2. Skema të bashkëfinancuara nga Banka

Skemat që do të bashkëfinancohen nga Banka përfshijnë mbikëqyrjen, sigurimin dhe zbatimin e punës përgatitore dhe asistencës teknike për:

punime në: (i) Durrës, (ii) Sarandë, (iii) Lezhë dhe Shëngjin me qëllim:

- ndërtimin, në total të 92 ha të kënetave trajtuese, duke përfshirë trajtim parësor të zgjeruar me ajrosje për KT Durrës, të kolektorit dhe të rrjeteve përkatëse të kanalizimeve, si dhe të lidhjeve për shtëpitë dhe të lidhjes me kanalizime të KT Shëngjin-Lezhë, si dhe të rrjeteve të tjera të kanalizimeve në zonat e plazhit të Sarandës dhe të Durrësit.

Punime në Korçë me qëllim:

- ndërtimin e disa kolektorëve të ujërave të zeza dhe objekte për ujin e shiut brenda dhe rreth qytetit, të rreth 12.5 km rrjeti dytësor kanalizimesh dhe atë të trajtimit të ujërave të zeza në një zonë prej 5.5 ha.

Sasitë e përcaktuara më lart janë me përafërsi dhe mund të ndryshohen, do të konfirmohen nga modeli i tenderit.

3. Orari

Skemat e bashkëfinancuara nga Banka do të zbatohen dhe komisionohen progresivisht gjatë periudhës 2003-2008.

SHTOJCA B EURIBOR

1. Euribor do të thotë, në lidhje me çdo periudhë të rëndësishme të përcaktuar në nenin 1.05B ose nenin 3.02, përqindje e interesit ndërbankar të dhënë në orën 11.00 (koha e Brukselit) ose në një orë të mëvonshme të pranueshme për Bankën në datën e vendosur përkatëse për depozita në euro me afat kohor njëmuor, si dhe e llogaritur nga Federata Europiane Bankare dhe më pas, apo brenda një kohe vonese të konsideruar të pranueshme nga Banka, të shfaqur në faqen Euribor 01 të Reuters (apo një faqe pasardhëse), apo në një burim tjetër të përcaktimit të përqindjes së zgjedhur për këtë qëllim nga Banka.

Për qëllimet e këtushme, "Datë e vendosur" do të thotë secila datë që bie dy ditë-pune përpara fillimit të periudhës të përcaktuar në nenin 1.05B dhe nenin 3.02.

2. Nëse kjo përqindje nuk publikohet në këtë mënyrë, Banka do t'u kërkojë zyra kryesore të katër bankave më të mëdha në eurozonë, të përzgjedhura nga vetë Banka, të japin përqindjen në të cilën depozitat në euro për një muaj, në një shumë të përafërt me atë në lidhje me të cilën do të përcaktohet Euribor të ofruar nga secili prej tyre rreth orës 11.00 A.M., ora e Brukselit, në datën e vendosur për bankat kryesore në tregun ndërbankar të eurozonës.

Nëse dorëzohen të paktën dy njoftime përqindjesh, përqindja që do të përdoret do të jetë mesatarja aritmetike e përqindjeve të dhëna.

Nëse dorëzohen më pak se dy njoftime përqindjesh, përqindja që do të përdoret do të jetë mesatarja aritmetike e përqindjeve të dorëzuara dy ditë-pune pas datës së vendosur nga bankat kryesore në eurozonë, të përzgjedhura nga Banka, për hua me afat njëmuor të dhëna bankave europiane kryesore në një shumë eurosh përafërsisht të barabartë me shumën në lidhje me të cilën do të përcaktohet Euribor.

3. Të gjitha përqindjet e rrjedhura nga llogaritje të përcaktuara në këtë aneks do të rrumbullakosen, nëse nevojitet, me një të njëqindmijetën e njëpërqindëshit, duke rrumbullakosur edhe gjysmat.

4. Dispozita plotësuese në lidhje me Euribor të adoptuara nga "ACI-Shoqata e tregjeve financiare", nëse Banka zgjedh kështu, mund të përfshihet në këtë aneks nëpërmjet një njoftimi për Huamarrësin.

LIGJ Nr.9227, datë 29.4.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9118, DATË 24.7.2003 "PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE TË PAPAGUARA"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9118, datë 24.7.2003 "Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të papaguara", bëhen ndryshimi dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:

"Për faljen e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore".

Neni 2

Në nenin 1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet shoqërore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4234, datë 26.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ

Nr.9228, datë 29.4.2004

PËR KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
OBJEKTIVAT, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIMET**

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme për përgatitjen e standardeve kontabël kombëtare dhe të pasqyrave financiare, si dhe për mbajtjen e kontabilitetit.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike të vendosura në Republikën e Shqipërisë, që kanë qëllime fitimprurëse, përfshirë institucionet financiare dhe shoqëritë kontrolluese, pavarësisht nga forma e tyre juridike ose nga kërkesat e veçanta ligjore, që mund të zbatohen ndaj tyre.

2. Ky ligj zbatohet edhe nga njësitë e tjera, që nuk kanë qëllime fitimprurëse, me përjashtim të rasteve kur pasqyrat financiare dhe kontabiliteti i tyre është subjekt i ligjeve ose i rregullimeve të veçanta.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. "Mbajtja e kontabilitetit" është regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike.

2. "Sistem kontabël" është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike.

3. "Standarde kontabël" janë parimet ose rregullat e përgjithshme, të shpallura nga një organizëm përgjegjës për normalizimin kontabël, që përcakton ky ligj, të cilat shërbejnë si bazë për zgjedhjen e trajtimeve ose të metodave kontabël, që zbatohen për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.

4. "Standardet Kontabël Ndërkombëtare (SKN) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)" janë standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare (IASB).

5. "Njësi ekonomike" janë personat juridikë dhe fizikë, publikë dhe privatë, me dhe pa qëllim fitimprurës, që kryejnë veprimtari dhe kanë seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë.

6. "Njësi ekonomike që ndjekin qëllime fitimprurëse" janë njësitë ekonomike, të cilat prodhojnë e realizojnë produkte, mallra e shërbime për shitje, me qëllim realizimin e fitimeve, të cilat parashikohen t'u shpërndahen personave investues në kapitalin themeltar të saj.

7. "Njësi ekonomike që nuk ndjekin qëllime fitimprurëse" janë njësitë ekonomike publike, buxhetore, të qeverisjes qendrore dhe vendore dhe njësitë që kontrollohen prej tyre, organizatat jofitimprurëse, si dhe çdo sipërmarrje tjetër private, publike, politike, shoqërore ose fetare, që nuk përputhet me përkufizimin e një njësie ekonomike që ndjek qëllime fitimprurëse.

8. "Evidenca mbështetëse" është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë.

a) Dokumentet bazë përmbajnë regjistrimet fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik;

b) dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë;

c) regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese.

9. "Bartësi informatik" është çdo dokument i evidencës mbështetëse, i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

Neni 4

Standardet kontabël që zbatohen për hartimin e pasqyrave financiare

1. Njësitë ekonomike që zbatojnë këtë ligj, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, zbatojnë standardet kontabël kombëtare për hartimin dhe publikimin e pasqyrave financiare. Standardet kontabël hartohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe brenda një muaji shpallen të detyrueshme për zbatim nga Ministri i Financave.

2. Ministri i Financave, pasi merr mendimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, shpall standardet kontabël të detyrueshme për zbatim për njësitë ekonomike publike, që nuk ndjekin qëllime fitimprurëse.

3. Standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të përkthyer në shqip, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, shpallen nga Ministri i Financave dhe zbatohen detyrimisht:

a) nga shoqëritë e listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë dhe filialet e tyre, subjekt i konsolidimit të llogarive;

b) nga bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare, të ngjashme me bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe të risigurimeve, fondet e letrave me vlerë dhe të gjitha shoqëritë e licencuara për të kryer veprimtari investimi në letrat me vlerë, edhe kur ato nuk janë të listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë;

c) nga njësi ekonomike të tjera të mëdha, të palistuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë, kur ato tejkalojnë kufijtë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për të ardhurat vjetore dhe numrin e të punësuarve.

KREU II

MBAJTJA E KONTABILITETIT DHE INVENTARIZIMI I AKTIVEVE E DETYRIMEVE

Neni 5

Mbajtja e kontabilitetit

Të gjitha njësitë ekonomike e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e parimeve dhe të metodave, që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

Neni 6
Evidenca mbështetëse

1. Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji.

2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes.

Neni 7
Inventari i aktiveve dhe detyrimeve

1. Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse.

2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.

Neni 8
Gjuha dhe njësia monetare e regjistrave kontabël

1. Regjistrat kontabël mbahen në gjuhën shqipe dhe vlerat shprehen në njësinë monetare shqiptare.

2. Dokumentet e shprehura në gjuhë dhe/ose në njësi monetare të huaja, të ardhura nga/ose të dërguara për njësitë ekonomike të huaja, që nuk kanë seli të përherëshme në Republikën e Shqipërisë, vlerësohen në pajtim me përmbajtjen e pikës 1 të këtij neni.

3. Njësitë ekonomike mund t'i regjistrojnë veprimet ekonomike dhe gjendjet e shprehura në njësinë monetare të huaja dhe i konvertojnë ato në njësinë monetare shqiptare, në përputhje me standardin kontabël përkatës.

KREU III
PARIMET DHE PËRBËRËSIT E PASQYRAVE FINANCIARE

Neni 9
Respektimi i standardeve kontabël

1. Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njësive ekonomike. Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit mund të autorizojë përjashtime në rastet kur zbatimi i një standardi të veçantë gjykohet se është i papërshtatshëm për të siguruar të dhëna të vërteta dhe të besueshme.

2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara.

Neni 10
Bazat dhe parimet mbështetëse

1. Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së njësive ekonomike, për një të ardhme të parashikueshme.

2. Të dhënat që përmbajnë pasqyrat financiare duhet të jenë të kuptueshme për përdoruesit, të cilët kanë njohuri të mjaftueshme për veprimtaritë ekonomike të biznesit dhe për kontabilitetin.

3. Të dhënat për elementet dhe për shumat që ndikojnë në vendimmarrjet ekonomike të përdoruesve paraqiten veçmas në pasqyrat financiare. Paraqitjet e grupuara lejohen vetëm për elemente me natyrë të ngjashme, shumat e të cilave nuk janë materiale.

4. Kompensimi ndërmjet një elementi të aktivitetit të bilancit dhe një elementi të detyrimeve, si dhe ndërmjet një të ardhure dhe një shpenzimi është i ndaluar, përveç rastit kur parashikohet ose autorizohet nga një standard kontabël.

5. Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

Neni 11

Krahasueshmëria

1. Pasqyrat financiare duhet t'u japin mundësi përdoruesve që të bëjnë krahasime ndërmjet ushtrimeve të ndryshme kontabël ose njësive ekonomike të ndryshme.

2. Paraqitja dhe klasifikimi i elementeve bëhen me koherencë nga njëri ushtrim kontabël në tjetrin, përveç rastit kur ndryshimi kërkohet nga një standard i ri kontabël ose kur ndryshimi çon në një paraqitje më të përshtatshme të ngjarjeve ose transaksioneve në pasqyrat financiare të njësive ekonomike.

Neni 12

Përbërësit e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare vjetore, përveç atyre që parashikohen në mënyrë të specifikuar nga standardet kontabël kombëtare, duhet të përmbajnë këto dokumente:

- a) bilancin kontabël;
- b) pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve;
- c) pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta;
- ç) pasqyrën e rrjedhjes së parasë (cash flow);
- d) anekset e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues.

Neni 13

Parimet e vlerësimit

Elementet futen në llogari dhe përfshihen në pasqyrat financiare, me shumat që përcaktohen, sipas standardeve kontabël.

Neni 14

Ushtrimet kontabël

1. Kohëzgjatja e ushtrimit kontabël është 12 muaj.
2. Ushtrimi kontabël fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përgjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 15

Gjuha dhe njësia monetare e pasqyrave financiare

1. Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në gjuhën shqipe dhe vlerat shprehen në njësinë monetare kombëtare.
2. Pasqyrat financiare mund të paraqiten në shifra të rrumbullakosura, nëse nuk shkaktohet humbje e të dhënave, që kanë ndikim të përdoruesit e këtyre pasqyrave.

Neni 16

Depozitimi dhe publikimi i pasqyrave financiare

1. Pasqyrat financiare të njësive ekonomike, duke përjashtuar ato të pikës 2 të këtij neni, depozitohen në gjykatat përkatëse ku ato janë regjistruar, jo më vonë se një muaj nga data e miratimit të tyre nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve ose nga organi tjetër përgjegjës.

2. Njësitë ekonomike publike, të cilat nuk ndjekin qëllime fitimprurëse, i depozitojnë pasqyrat e tyre financiare brenda afateve dhe në vendet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Ruajtja e dokumenteve

Regjistrat kontabël dhe evidencat mbështetëse ruhen për 10 vjet rresht pas mbylljes së vitit ushtrimor kontabël, të cilit i përkasin, përveç atyre që, me ligj ose akt tjetër nënligjor, përcaktohet një afat më i gjatë ruajtjeje. I njëjti afat zbatohet edhe për dokumentet informatike (bartësit) dhe printimet e tyre.

Neni 18

Përgjegjësitë

1. Organi i drejtimit ekzekutiv të njësisë ekonomike dhe organi i tij mbikëqyrës, të punësuar ose jo, janë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha kërkesave, të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji.

2. Ekspertimi ligjor i pasqyrave financiare nga ekspertë të pavarur të licencuar nuk e çliron organin e drejtimit ekzekutiv dhe atë mbikëqyrës të njësisë ekonomike nga përgjegjësitë, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

KREU IV

KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Neni 19

Statusi dhe detyrat

1. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit krijohet si organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik.

2. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka për detyrë:

a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe në koherencë me Standardet Kontabël Ndërkombëtare.

Nëse për arsye të legjislacionit dhe të praktikave kontabël brenda vendit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit e shikon të nevojshme që të shmanget nga zbatimi i disa standardeve, ai e ka autoritetin që ta bëjë një gjë të tillë, vetëm pasi të shpjegojë dhe të justifikojë arsyet e këtij veprimi;

b) të përpunojë një sistem kontabël, ku përveç standardeve kontabël kombëtare, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, listat e llogarive dhe përdorimin e tyre, si dhe formatet për pasqyrat financiare;

c) të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;

ç) të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;

d) të shqyrtojë dhe të japë mendime për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin, për përgatitjen e llogarive, që lidhen me njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, si dhe me profesionet me bazë kontabilitetin;

dh) të vendosë marrëdhënie me organizata profesionale vendase e të huaja dhe të marrë pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare për kontabilitetin.

Neni 20

Përbërja dhe zgjatja e mandatit

1. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit përbëhet nga 9 anëtarë, prej të cilëve:
 - a) dy anëtarë propozohen nga organizatat e profesioneve të lira kontabël, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi;
 - b) dy anëtarë propozohen nga fakultetet e ekonomisë;
 - c) dy anëtarë propozohen nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë;
 - ç) tre anëtarë propozohen nga Ministri i Financave.
2. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit mandatohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit kanë mandat 6-vjeçar dhe mund të rimandatohen me propozimin e subjektit përkatës, me miratimin e Këshillit të Ministrave.
4. Për të siguruar vazhdimësinë në përbërjen dhe punën e këshillit, njëri nga anëtarët e mandatit të parë, i përcaktuar me short nga secili subjekt që i ka propozuar, ka mandat 4-vjeçar, me të drejtën e rimandatimit.
5. Kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) të kenë diplomë universitare në fushën e kontabilitetit;
 - b) të kenë titullin "Profesor" ose gradën shkencore "Doktor i shkencave" prej jo më pak se 3 vjetësh, ose të kenë një "Master në kontabilitet dhe/ose financë", prej jo më pak se 5 vjetësh;
 - c) të kenë përvojë pune mbi 10 vjet në fushën e kontabilitetit;
 - ç) të kenë përvojë në udhëheqjen metodologjike dhe në hartimin e akteve ligjore e nënligjore dhe të metodikave në fushën e kontabilitetit dhe të financave;
 - d) të kenë autoritet profesional të njohur dhe figurë të pastër morale.
6. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për realizimin e detyrave angazhohet me kohë jo të plotë pune.
7. Për të mbështetur veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, krijohet një strukturë administrative me personel të punësuar. Struktura, organika, pagat për të punësuarit dhe honoraret e anëtarëve të këtij këshilli, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
8. Anëtarit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit i hiqet mandati para përfundimit të tij, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm në rastet kur ai:
 - a) vdes;
 - b) bëhet i paaftë për shkak sëmundjeje;
 - c) kryen një vepër penale;
 - ç) nuk përmbush kërkesat e caktuara në Rregulloren e Brendshme të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Neni 21

Organizimi dhe funksionimi

1. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, procedurat për hartimin e standardeve kontabël kombëtare dhe të produkteve të tjera, të realizuara nga anëtarët e këtij këshilli ose të tretët, përcaktohen në rregulloren e brendshme të tij, e cila propozohet nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.
2. Kryetari dhe Nënkyetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit zgjidhen nga anëtarët e këshillit, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme.

Neni 22

Burimet e financimit

1. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit financohet nga Buxheti i Shtetit. Ai ka të drejtë të përdorë edhe të ardhurat që realizon nga punët që kryen.

2. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit mund të përdorë financime dhe donacione nga subjektet dhe organizmat financiarë dhe profesionalë vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 23

Shkeljet dhe dënimet

Rastet e shkeljeve të kërkesave të këtij ligji janë objekt i masave ndëshkimore administrative, civile ose penale, në masën e dëmit të shkaktuar, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Kodit Penal ose ligjeve të tjera, në bazë të kërkesë-padive të bëra nga palët e interesuara.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24

Zbatimi i ligjit

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, deri në hyrjen në fuqi të ligjit, të nxjerrë aktet në zbatim të neneve 19, 20 dhe 21 të këtij ligji, për organizimin dhe funksionimin e strukturave dhe të organeve të parashikuara në ligj.

Neni 25

Zbatimi i lirë

Njësitë ekonomike lejohen t'i zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit para datës që këto standarde shpallen të detyrueshme për zbatim.

Neni 26

Shfuqizime

Ligji nr.7661, datë 19.1. 1993 "Për kontabilitetin", shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2006.

**Shpallur me dekretin nr.4235, datë 26.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ

Nr.9229, datë 29.4.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8950, DATË 10.10.2002 "PËR
GJENDJEN CIVILE"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin 8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Pika 5 e nenit 34 ndryshohet si më poshtë:

"5. Deklarimi i lindjes së fëmijës bëhet brenda 45 ditëve. Pas mbarimit të këtij afati, lindja konfirmohet me vendim gjykatë.".

Neni 2

Shkronja "b" e pikës 3 të nenit 35 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 37 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Ndryshimi i emrit e i mbiemrit bëhen në librin e procesverbaleve, pas miratimit të kërkesës së shtetasit nga punonjësi i zyrës së gjendjes civile, ku ka regjistrin themeltar. Në procesverbal pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkaku i ndryshimit, si dhe emri e mbiemri të ndryshuar. Procesverbalin nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga punonjësi i gjendjes civile dhe drejtuesi i zyrës së gjendjes civile, nëse ka të tillë. Emri e mbiemri të ndryshuar, si dhe numri dhe data e procesverbalit pasqyrohen në regjistrin themeltar të gjendjes civile.".

2. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

"10. Ndryshimet dhe korrigjimet e bëra në zyrën ku ndodhet regjistri themeltar i gjendjes civile u dërgohen, brenda 10 ditëve, Zyrës së Gjendjes Gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe qendrave të rekrutim-mobilizimit të qarqeve përkatëse.".

Neni 4

1. Në pikën 3 të nenit 50, fjalët "brenda tri ditësh" bëhen "brenda dhjetë ditësh".

2. Pika 6 e nenit 50 shfuqizohet.

Neni 5

1. Pikat 1 dhe 2 të nenit 69 ndryshohen si më poshtë:

"1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e përmendura më poshtë, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) shkelja ose moszbatimi i dispozitave të parashikuara në nenet 12 pika 5 dhe 50 pika 3 dënohet me gjobë në masën 1 000 lekë;

b) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në pikën 5 të nenit 34 dënohet me gjobë në masën 2 000 lekë;

c) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në pikën 2 të nenit 63 dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.

2. Gjobat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" vendosen nga punonjësi i gjendjes civile. Veprimet pezullohen deri në pagimin e gjobës. Kundër masës administrative mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve, te prefekti i qarkut, i cili brenda 15 ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër vendimit të prefektit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

Gjoba e parashikuar në shkronjën "c" vendoset nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile. Kundër masës administrative mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve, te Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, i cili brenda 15 ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër vendimit të ministrit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.".

Neni 6

Neni 72 shfuqizohet.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4236, datë 26.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

VENDIM

Nr.131, datë 19.4.2004

**PËR KOMISIONIN HETIMOR PARLAMENTAR PËR HETIMIN NË KORPORATËN
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe të nenit 164 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për hetimin në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH).

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për detyrë hetimin e informacioneve publike dhe të denoncimeve të bëra për problemet dhe detyrat që kryen KESH-i. Në mënyrë të veçantë Komisioni Hetimor duhet të hetojë rreth informacioneve dhe denoncimeve për menaxhimin e rezervës ujore të sistemit hidroenergjetik, për praktikatat e prokurimeve publike, sidomos për shitblerjen e energjisë elektrike nga KESH-i, për praktikatat e faturimit të konsumit të energjisë elektrike për konsumatorët privatë, si dhe për aplikimin e regjimit të kufizimeve të energjisë elektrike.

III. Periudha që do të mbulohet nga hetimi është periudha nga data 1 janar 2002 deri në datën 30 prill 2004, por, nëse del e nevojshme, Komisioni mund të hetojë edhe që nga viti 1994.

IV. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga maxhoranca parlamentare dhe 5 nga opozita, si më poshtë:

- | | |
|-------------------|-------------------|
| 1. Jemin Gjana | - Kryetar |
| 2. Eduard Alushi | - zëvendëskryetar |
| 3. Dilaver Qesja- | anëtar |
| 4. Edi Paloka | - “ |
| 5. Alfred Çako | - “ |
| 6. Jak Ndokaj | - “ |
| 7. Ejup Tabaku | - “ |
| 8. Flamur Hoxha | - “ |
| 9. Lekë Çukaj | - “ |
| 10. Kristo Goci | - “ |
| 11. Ndue Preka | - “ |

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej dy muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të marrë të gjitha masat administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Makbule Çeço

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

SË SHPEJTI NË BOTIM:
INDEKSI TEMATIK DHE KRONOLOGJIK
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

Doli nga shtypi më 7.6.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë